

KOSOVARJA

Ballina: Prek Karricaj

A jemi
në udhë
të Zotit

Fukaraja
do bukë,
jo politikë

Ku është
Hamami
i Hyrës

Mushtishti
i këngëtareve
nacionaliste

Burri im
si dreqi
me një këmbë

Amir Mjeku
zbulon
të fshehtat
e VIP-ave

Pse
Kaltrina Selimi
kurrë nuk bëhet
bajat

**PREK
KARRICAJ**

*frizeri shqiptar
me famë në Zvicër*

'Hazrolli Unternehmensgruppe',
grupi i kompanive më të suksesshme
kosovare të ndërtimit në Gjermani –
Anëtare dhe Koordinatorë e UB

remos

MOLLA

a.g.e.stop
SWITZERLAND


JARDIN
PARIS BELGIJA

allure

BREZOVICA

UNIK
HOTEL

CIMA
ECONOMY CLASSIC



UB
UNION BUSINESS
ALBANISCH & DEUTSCH

DINO
CERAMICHE

Shkabaj

DENTFIX

Shkunda Dikera

SHERWOOD

iAs

anaderm

BETON




HOTELERI



DINO COMPANY

NDËRTIM



QERAMIKË



📍 Magjistrallja Prishtinë - Ferizaj
🏠 Fsh. Konjuh 14000 Lipjan, Kosovë

📞 + 383 44 206 586
🌐 www.dino-5.com

Cili shqiptar e masakroi Izbicën?



Milazim Thaçi

Kur ishte para Millosheviqit, si dëshmitar për masakrën e Izbicës, Milazim Thaçi i kishte thënë “Kasapi i Ballkanit” se vetë shqiptarët i kanë vrarë shqiptarët e Izbicës. Dhe, u zbulua se paska qenë një shqiptar që ka bërë kërdi në Izbicë!

22 vjet pas krimit në Izbicë, u zbulua një krim i ri. Doli diçka e papritur që tronditi shqiptarët dhe Kosovën. Të mërkurën e fundit e marsit 2021, u kumtua lajmi se për masakrën e Izbicës u arrestua një shqiptar, që paska jetuar në Beograd gjatë tërë pasluftës. Ai paska vrarë shqiptarë në fshatin Izbicë të Drenicës.

Milazim Thaçi, me plis, nga Buroja e Skënderajt, ka qenë dëshmitar kundër Millosheviqit në Hagë për krimet serbe në Izbicë. Dhe, duke folur në emisionin “Frontal”, ai e përshkroi masakrën e Izbicës me lot, duke treguar se si i ka mbijetuar masakrës së Izbicës, falë dy të vrarëve që i ranë mbi trup, në grupin e të pushkatuarve prej 33 vetash, në fund të livadhit bregor.

NË DITËN E KURBAN BAJRAMIT NDODHI KIAMETI!

“Të shtunën kemi qenë në Izbicë, atë ditë na kanë thënë t’i qesim traktorët në livadh. Atë natë ka qenë nata e Kurban Bajramit dhe na ka bërë havëll një grua ku qëndronim ne. Aty na ra me flejt atë natë. Në mëngjes na kishin rrethuar serbët. Deshi Zoti që djemtë e ri ikën të shtunën dhe mbetëm disa pleq, gra e fëmijë.

Ne, pastaj, i kemi bajtur 60 traktora deri në livadh. Kur i kemi qit, fillim me ngrënë bukë aty. Duke ngrënë bukë



Kompleksi memorial në Izbicë

erdhën 3 serbë. U thash se dua të shoh se çfarë po thonë...

Kur shkova, ma bënë me dorë - hajde jepna 1 mijë marka. Ju thash, nuk kam. I nxjerra 50 marka. U thash merrni këto! Më thanë: “Qit, qit!”. U thash - s’kam.

Gratë që ishin aty nxorën para sa kishin dhe ua dhanë”, tregoi Milazimi, duke e përshkruar ngjarjen si ditë kiameti dhe vazhdoi:

“Aty kiamet kam pa. Bërtitshin fëmija, bërtitshin gratë... Unë e kam ditur se do të na vrasin... Komandanti i tyre erdhi dhe u tha serbisht: “Të gjithë e dini punën tuaj dhe nisjani menjëherë!”. Serbi na tha: “Ngrituni në këmbë! Kthehuni majtas dhe ecni arës përpetjet!”.

Na bënë rresht nga dy. Në grupin e parë ishim 33 persona. Na thanë se juve duam t’ju dërgojmë në Pejë dhe të tjerët në Klinë. Por, njëri na bërtiti: “Ndaluni! Kthehuni majtas!”.

Dhe, posa ka thënë uluni në gjunjë, kanë shtënë 3 herë me mitraloz. Nuk e di a më ka rënë të fikët mua a çka tjetër, por kur jam këfjell i kam pas dy kufoma përmbi. Ka qenë Ukë Thaçi dhe Isuf Zeqaj. Ata dy i kam mbajtur mbi trup nja 40 minuta”.

Flitej se në mesin e policëve ishte edhe një shqiptar!

Ai ka dëgjuar se si atë ditë në Izbicë, në mesin e forcave serbe, kishte qenë edhe një shqiptar, por emrin e tij nuk ka arritur ta kuptonte deri më tash. Dhe, arrestimi i një shqiptari për masakrën e Izbicës, i ka irrituar shumë familjarët e viktimave të Izbicës dhe shqiptarët në përgjithësi.

Nuk kishim dëgjuar deri më tash që një shqiptar të ketë qenë me çetnikët e Serbisë dhe të masakrojë shqiptarë. Megjithatë, pas 22 vjetësh të krimit, ndodhi ashtu siç thotë populli: “Gjaku nuk humb kurrë!”.

Safet Krivaça

Në ballinë: Prek Karricaj

Prek Karricaj,

frizeri shqiptar me famë në Zvicër

Floku është bukuri, andaj njerëzit kujdesen gjithmonë për mirëmbajtjen e flokëve, duke i prerë, krehur, stiluar e trajtuar në mënyra nga më të ndryshmet...



Prek Karricaj është pronar i tre salloneve të famshme "Coiffeur Karricaj", dy prej të cilëve janë vetëm për meshkuj, ndërkaq njëri, i hapur para pak muajsh, ofron shërbime profesionale të parukerisë për femra dhe meshkuj, kryesisht shkak i kërkesës së madhe të klienteles.

PREK KARRICAJ - NJERIU QË E DO PUNËN

Artisti i flokëve, Prek Karricaj, është profesionist i vërtetë i fushës së parukerisë, me tre sallone shumë të frekuentuara në Zvicër, ku ofrohen të gjitha shërbimet e kërkuara.

Mjeshtri i flokëve, Prek Karricaj, është me prejardhje nga Gjakova, por prej vitesh jeton dhe punon në Zvicër, në kantonin e Aragaut.

Profesionin e frizerit e ka nisur në vitin 2002 dhe që atëherë ka pasur shumë suksese, ku numri i klientëve meshkuj e femra veç është rritur.

"Po bëhen shumë vjet që punoj në



këtë zanat dhe, fatmirësisht, më ka ecur mirë, ndoshta edhe pse e kam dashur dhe e dua shumë punën. Unë përkushtohem maksimalisht që bashkë me stafin ta bëjmë më të mirën të klientët, e kjo ka dhënë rezultate të qëndrueshme pozitive", thotë Karricaj.

ME KLIENTELË TË TË GJITHA NACIONALITETEVE

Prek Karricaj, falë punës dhe vullnetit, arriti të hapë tre sallone "Coiffeur Karricaj": një në Arau, një në Weitingen në kanton të Aragaut dhe një në Niedergösgen, në kantonin Soloturn. Siç kuptojmë, në "Coiffeur Karricaj" shkojnë klientë të të gjitha nacionaliteteve dhe kërkojnë lloje të ndryshme të frizurave, nga ato klasiket e deri te më modernet.

"Kemi klientelë të gjerë të të gjitha nacionaliteteve. Kemi shumë shqiptarë e shqiptare, por edhe të tjerë që vijnë dhe ndahen të kënaqur nga shërbimet që marrin.

Këtu nuk ka ndasi ose paragjykimë në bazë të nacionalitetit. Puna e mirë flet me gjuhë universale", thotë Karricaj.

10 VJET "COIFFEUR KARRICAJ"

Në sallonet e njohura "Coiffeur Karricaj" kryhen shërbime profesionale për të dy gjinitë, si: prerje, stilim, frizura, ngjyrosje, shatire etj.

"Me kërkesën e klientëve, para tetë muajsh, kemi hapur edhe një sallon ku punojmë edhe me femra dhe suksesi ka qenë i madh që në ditët e para, çka na ka befasuar, por edhe na ka gëzuar njëkohësisht. Përndryshe, javë më parë kemi renovuar dhe zgjeruar edhe sallonin tonë të parë "Coiffeur Karricaj", që tashmë ka një pamje edhe më moderne dhe një komoditet të paparë", tregon Prek Karricaj, i cili këto ditë festoi dhjetëvjetorin e hapjes së biznesit të tij të parë.

"Para pak ditësh festuam dhjetëvjetorin e hapjes së sallonit të parë, me ç'rast kishim disa të ftuar. Por, shkak i pandemisë nuk arritëm të bënim diçka shumë të madhe, siç donim. Sidoqoftë, e rëndësishme është se e shënuam këtë përvjetor të rëndësishëm me një festë të këndshme... Madje, dhjetëvjetori i "Coiffeur Karricaj" u shënuar edhe në media, si suksesi i një shqiptari në Zvicër", tha frizeri i njohur Prek Karricaj, imazh i këtij numri të revistës sonë, "Kosovarja".

N. Neziri





Fukaraja do bukë, jo politikë!

Fukaraja mash-trohet lehtë. Duke qenë në kërkim të bukës dhe ushqimit për fëmijët, ai bëhet i besueshëm ndaj politikanit. E, politikani, ndërkaq, i ka qëllimet e veta, që ta qojë veten përpara deri aty ku i ka bërë llogaritë e veta.

Një i varfër po qëndronte në rrugë dhe pranë tij po kalonte një fallxhi. I varfëri e luti fallxhiun t'i tregonte nëse do të kishte diçka më mirë në jetën e tij. Fallxhiu e mori dorën e tij dhe, pasi ia shikoi vijat, i tha: "Sivjet nuk të pret diçka më mirë se tash!".

"Të lutem, po vitin tjetër, a do të jem më mirë?", i tha i varfëri.

"As vitin tjetër nuk pritet të jesh më mirë se tash!", i tha fallxhiu.

"Po tjetrin vit, si do të jetë puna ime dhe a do të kem bukë për fëmijët?", i bëri pyetjen tjetër fallxhiut.

"Eh, pas tre vjetësh po të del më mirë", ia ktheu ai.

"Ah, më në fund, po vijnë ditë më të mira për mua, a?!", i tha i varfëri fallxhiut.

"Pas tre vjetësh mësohesh me këtë gjendje që e ke dhe të duket krejt mirë!", ia ktheu ai.

Dhe, po e marrë një shembull që ndodhi para tre vjetësh gjatë fushatës zgjedhore në fshatin tim...

Gjatë fushatës zgjedhore për të parin e komunës, erdhi në shitoren time në fshat i pari i arsimit të komunës dhe, pasi u takua me disa fshatarë, njëri ndër ta ishte edhe prindi i një djaloshi që para dy vjetësh e kishte kryer shkollën e mesme me të gjitha notat pesë.

"Ah, ti je prindi i Gazit, a?! Ishte nxënësi më i mirë në komunën tonë. Po ku ndodhet ai tash?", i tha drejtori i arsimit prindit të Gazit.

"Po punon kamerier në një restorant në Lipjan. Nuk pata para ta shkolloja tutje, në fakultet!", ia ktheu prindi drejtorit të arsimit dhe vazhdoi: "Unë jam invalid qëkur isha në UÇK dhe mëzi po mbijetojmë diqysh... Edhe vajzën e kam në shkollë të mesme dhe po mëson sikur djali, por veç djali në mujt me e shkollua në fakultet se unë jo!".

Dhe, fill pas këtyre fjalëve, drejtori i arsimit iku, sepse pa se këtu nuk kishte përkrahës për votën e tij...

S. Murturi

Pronar dhe botues:
Gani DILIRedaktor përgjegjës:
Isa ILAZIMenaxher:
Driton DILI

Redaksia:
 Safet Krivaça (reporter i lirë)
 Nderim Neziri (redaktor)
 Besiana Dili
 Drenushë Haredinaj
 Rilinda Krasniqi
 Dionita Sadrija
 Gresa Mehmeti

Dizajni:
 Labinot Bërbatovci

Adresa e redaksisë:
 Fahu postal 18, 10000 Prishtinë
Tel: 038 51 75 75
Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:
 Tel: +383 44 143 448;
Email: marketing@kosovarja-ks.com

E SOTMJA TA QON MENDJEN KAHMOS...

A PAJTOHENI?

S'e kam prej nostalgjisë, siç do më thoshin... Por, në kohën paraprake, jo të largët, miqtë kanë qenë të vërtetë, pa maska. Po ashtu, solidariteti ndaj njëritjetrit, për njëri - tjetrin ka qenë për lakmi dhe që na ka mbajtur në kohë të rëndë, të zorshme...

Jo vetëm miqtë, sot ka ndryshuar e ndërruar shumëçka.

A pajtoheni?

A DO TË DIJË NJERIU TË DASHUROJË SI DUHET?

Të gjithë e kemi jetën tonë. Bota ka vuajtur shumë për të arritur në këtë gjendje dhe ne duhet të kërkojmë që të organizojmë në mënyrën më të mirë, që të arrijmë të lumturën shpirtërore. Jetojmë, por në këtë jetë gjithmonë mungon dhe na mungon diçka. Për këtë jemi edhe në këtë jetë, që të arrijmë aty ku na plotësohet mungesa. Kur Dante Aligeri shkruante "Komedinë hyjnore", ka thënë: "Atë ditë kur njeriu do të lejojë të shfaqet dashuria e vërtetë, gjërat që duken të organizuara do bëhen rrëmujë dhe do të jenë kundërpeshë e gjithë asaj që ne e mendojmë si të drejtë, që është e vërteta". Bota do të bëhet e vërtetë vetëm kur njeriu

do të dijë të dashurojë. Deri atëherë do të jetojmë duke besuar se e njohim dashurinë, por pa e pyetur kurrë guximin që ta përballojmë ashtu siç është në realitet.

*

Mirë e kanë pasur ata që kanë thënë: Dashuria është një forcë e egër. Kur do të përpiqemi ta kontrollojmë - na shkatërron. Kur tentojmë ta burgosim - na bën skllevër. Kur mundohemi ta kuptojmë - na lë të hutuar...

*

...dhe ai që thoshte: i urrej lamtumirat, sidomos në stacione, qofshin të autobusëve, të trenave, qofshin në aeroporte... Nuk e dua lamtumirën!

*

Përse i duam disa njerëz dhe ca të tjerë i urrejmë?
 Pse lindim, nëse një ditë duhet të vdesim?
 Koha m'i imponon t'i bëj këto pyetje sikur atëherë kur nënës sime ia bëja kur isha i vogël, fëmijë...
 "Kuku, o djali jem, po ku, kah, çka po të bien në mend?!"
 E sotmja ta qon mendjen kahmos...

Gani Dili



Politikanët në luftë për pushtet, *pensionistët në skamje!*

Populli është lodhur, sepse, edhe pse kaluan mbi 20 vjet pas lufte, jemi keq, në skamje, sidomos pensionistët.

Pa dyshim, në Kosovën tonë të lirë, e që ishte ëndërr e shumë brezave, më të mjerët kanë mbetur pensionistët, sidomos në këtë kohë pandemie, ku edhe shumica prej tyre janë prekur nga virusi covid, e shpenzimet për shërim janë shumë të mëdha, kurse me ta nuk merret askush!

Populli për nga lodhja ma kujton rastin e kuajve të xha Jupit, fqinjit tim. Ai ishte shakaxhi dhe shkonte në dasma odë më odë. Në një dasmë, e cila bëhej në pranverë, e pyesin: "A munde t'i nxjerrësh bagëtinë gjallë në Shëngjergj, o Jup?".

"Mirë dolën: Njëri kalë gati ngrihet vetë në këmbë, e tjetrit pak me i ndihmu qohet..."

Kështu është edhe me popullin tonë: i lodhur e i dërmuar tej mase, sa që një ditë nuk do të mund të ngrihet as në këmbë...

Njëri prej burrave e kishte pyetur Jupin: "Pse lodhen sytë?".

I ishte përgjigjur:

"Merr syze dhe mbrojtë sytë! Por, edhe me syze mund të sharrosh!".

Shkon një plak te mjeku dhe merr syze zmadhuese. Me syze nis të

kalojë lumin në Nerodime, lumë me ujë të kthjellët që vjen nga bjeshkët e Jezercit.

Shikon ku ta hedhë këmbën dhe i duket se kishte vend të mjaftueshëm mbi një gur, e që syzet zmadhuese ia kishin zmadhuar fort.

Lëshon këmbën mbi guri, duke menduar se është i madh dhe sharron deri në kërdhokull. Në ato çaste i kujtohen fjalët e Jupit: "Edhe me syze mund të sharrosh!".

E, kështu po ndodhë edhe me dialogun Kosovë-Serbi, e që herë vazhdon e herë ndërpritet... Sepse, Kosova me Kushtetutën e vet, Serbia me të veten! Por, një gjë është e sigurt: Dikush do të fitojë e dikush do të humbë... Dhe, sillu e pështillu, barra prapë do bie mbi popullin...

Isa ILAZI

Të mos harrohen ata që kontribuuan...

Nazif Tasholli dhe familja e Haradin Tashollit e ruajtën Shpellën e Gadimes gjatë luftës, më mirë se që ruhet sot, kur edhe e kemi shtetin tonë...



Kush e ruajti Shpellën e Gadimes gjatë luftës?

Shpella e Gadimes së Lipjanit, në kohën kur në Kosovë çdo gjë shkatërrohej nga Serbia, u la tërësisht në mëshirën e kohës dhe pa mbrojtje. Në kohën e luftës shpella ishte në mëshirën e paramilitarëve, që silleshin kudo rreth saj. Por, pat edhe të tillë që e ruajtën shpellën në kohën e luftës së vitit 1999. E, ata ishin Nazif Tasholli dhe familja e Haradin Tashollit.

A DO ISHTE SHPELLA E GADIMES SI ËSHTË SOT PO TË MOS ISHTE NAZIF TASHOLLI?

Realisht, ai dhe familja e tij atë vit të vështirë lufte dhe të pranisë paramilitare në Gadime, i kanë meritat më të mëdha që shpella mbeti kjo

që është sot.

Sepse, askush nuk mund të siguronte ekzistimin dhe mos-dëmtimin apo asgjësimin total të Shpellës, sikur të mos ishte Nazif Tasholli dhe familja e Haradin Tashollit, si familje e madhe, duke e mbrojtur atë.

Në atë kohë nga shpella nuk përfitohej asgjë, pos që duhej të investohej. Andaj, për ta mbajtur në gjendje të rregullt shpellën dhe për ta sjellë në ditët tona kështu siç është sot, nuk ka qenë e lehtë...

Përkundrazi, ka qenë sfidë dhe problem, që nga siguria e deri te investimi familjar, sepse shpella ishte harruar e lënë anash, meqë nuk ishte objekt turistik profitabil, por më shumë objekt në të cilin duhej të investohej nga vetë familja e Haradin Tashollit.

SHKOLLARËT DHE KFOR-I E VIZITOJNË SHPELLËN, QYTETARËT E INJOROJNË!

Deri me fillimin e pandemisë në Kosovë shpella e Mermertë në Gadime vizitohej me të madhe nga shkollarët për qëllime mësimore. Dhe, herë pas herë, edhe nga vizitorë të rrallë anë e kënd Kosovës. Shpella e Gadimes vizitohej edhe nga misionarët e KFOR-it dhe nga ndërkombëtarë të tjerë. Por, fatkeqësisht, të paktë janë qytetarët që e vizitojnë shpellën, sepse nuk kemi kulturë slllovene, ku ditë e natë e vizitojnë shpellën e Postojnës, e që nuk është asgjë më interesante sesa shpella jonë, e cila nuk është më larg se 20 kilometra nga Prishtina, kryeqyteti i Kosovës.

S. Murturi

Krejt mbrapsht...

*Te ne, në Kosovë,
hasë në gjithçka: në
njerëz të varfër e të
pasur, në të zhurm-
shëm e të heshtur,
në njerëz që derd-
hin lot dhe në të tillë
që janë në qejf nga
rakia, në shtëpi ka-
solle e në pallate
shumëkatëshe...*

Prishtina është bërë vend i zhurmshëm. Kushdo që vjen nga jashtë thotë se këtu ka zhurmë, ka jetë. Se atje ku jetojnë e punojnë nuk dëgjohet kush për së gjalli, secili shikon punën e vet, rrugën e vet.

Te ne kafenetë janë plot me njerëz. Zhurmë sa të duash. Tym duhani si mjegulla e dendur dimrit kur e përfshinë Aeroportin e Prishtinës.

Thënë shkurt, vetëm pak ditë para se t'i qes në letër këta pak rreshta, isha në kafenenë përballë Redaksisë. Aty pi kafenë e mëngjesit me shokët e punës. Por, përballë kafenesë ndodhet shkolla "Elena Gjika" dhe po qëlllove në kohën kur nxënësit dhe arsimtarët ndodhen në pushim, zhurma shkon deri në kupë të qiellit! Kështu ishte sot, por ishte edhe dje...

SYZET MBI FLOKË!

Te ne, si çdo herë, tejet në modë janë syzet. Të rralla janë femrat pa syze. Madje, edhe meshkujt! Por, pakkush i mbanë në sy. Pjesa dërmuese i mbanë mbi flokë!

I mbrojnë flokët nga dielli pranveror, apo?

Ndoshta e dinë se syzet jo origjinale i dëmtojnë sytë dhe mu për këtë i mbanë mbi flokë, që të tregojnë se kanë syze, se janë në trend me kohën...

A mos kënaqemi sa për sy e faqe?

A jemi ne, kosovarët, në udhë të Zotit apo këtë e bëjmë sa për sy e faqe?

Në këtë pyetje përgjigjen mund ta gjej më së miri te njëri që e njoh mirë, sepse e kam pasur edhe udhëheqës, i cili tërë vitin i mbanë tespihët në dorë



A jemi në udhë të Zotit?

e pinë raki, kurse në Ramazan agjëron! "Po i bëjnë njëmijë të zeza dhe po shkojnë në xhami". Këto fjalë i dëgjova nga një shitës në "Tregun e Gjelbër" në Prishtinë, javën që shkoi, teksa bisedonte me një blerës, e që biseda e tyre vazhdoi edhe tutje, kryesisht rreth fesë...

Dhe, nganjëherë, si duket, "fjalët e çarshisë" janë të vërteta, janë për t'u besuar...

VETURAT LUKSOZE

Të gjithë jemi dëshmitarë të një sërë ngjarjesh interesante nga jeta

e përditshme. Ngjarje që lidhen me njerëz të ndryshëm, me të atillë që ecin në këmbë dhe në të atillë që nuk zbresin nga vetura veçse kur hyjnë në shtëpi. Madje, edhe bukë kur shkojnë me ble shkojnë me veturë!

Edhe për këtë kam një fakt. Një shok imi, i cili, shyqyr Zotit i ka punët mirë, ka veturë luksoze. Por, apetitet i ka të mëdha: do e ndërrojë veturën që e ka me një edhe më luks! E pse, e di ai!

Isa ILAZI

'Hazrolli Unternehmensgruppe', grupi i kompanive më të suksesshme kosovare të ndërtimit në Gjermani – Anëtare dhe Koordinatorë e UB



'Hazrolli Unternehmensgruppe', veç tjerash ofron shërbime edhe në fushën e punimeve kryesore të shpimit dhe sharrimit, mbështetje të plotë për shitjet e pasurive të patundshme e cila është edhe si pjesë integrale e profilit të kompanisë.

Duke shfrytëzuar një përvojë shumëvjeçare në fushën e njohurive teknologjike moderne, 'Hazrolli Unternehmensgruppe' ofron po ashtu zgjidhje ideale në inovacionin e energjisë efëiente dhe mbrojtjes së klimës për shtëpitë apo ndërtesat tuaja, duke përdorur materialet e dorës së parë.

Produktet e 'Hazrolli Unternehmensgruppe' janë: dritare evropiane elegante, dyer që ofrojnë një ambient të ndritshëm, pastaj shërbimet si instalime, riparime, konsultime dhe dizajn, fasada strukturale gjiindera dhe shumë shërbime të tjera të cilat u nevojiten shtëpive apo ndërtesave tuaja.

Një ndër sukseset e padiskutueshme të 'Hazrolli Unternehmensgruppe', ishte kur në Kampionatin e Ndërtimit të vitit 2014 në Ausburg, mori vendin e parë me pllaka gipsi.



E themeluar që nga viti 2005 në pjesën e Bavarisë – Bajernit në Gjermani nga vëllezërit e suksesshëm afaristë nga Kosova Hazrolli, grupi i ndërmarrjeve 'Hazrolli Unternehmensgruppe', ndër vite është zgjeruar si bashkim i kompanive të specializuara e shumë të kualifikuara me një gamë të gjerë fokusesh në sektorin e përgjithshëm të ndërtimitarisë në Gjermani dhe Kosovë.

'Hazrolli Unternehmensgruppe', me në krye drejtorin gjeneral, Burim Hazrolli, është një ndër kompanitë anëtare dhe njëherësh koordinatorë e Unionit të Bizneseve Shqiptare – Gjermane e cila me shumëllojshmërinë e aktiviteteve në fushën e veprimtarisë së ndërmarrjeve individuale të saj ofron shërbime duke filluar nga ndërtimet e reja, modernizim dhe renovim në lëmin e ndërtimitarisë.

Me një ekip shumë profesional dhe të motivuar për të punuar me një përkushtim të madh, i përbërë nga 100 punëtorë me përvojë nga fushat e arkitekturës, inxhinierisë, IT, dhe pasurive të patundshme, 'Hazrolli Unternehmensgruppe', është partneri më i fortë në projektet tuaja, por edhe një kompani e njohur trajnimiti.

Historiku i zgjerimit të ndërmarrjeve 'Hazrolli Unternehmensgruppe'

- Viti 2005 - Themelimi i kompanisë Hazrolli.
- Viti 2013 - Kompania është riemëruar Hazrolli Bauunternehmung GmbH & Co. KG.
- Viti 2014 - Hapja e Hazrolli Wohnungsbau GmbH për ndërtimin dhe shitjen e pasurive të patundshme.
- Viti 2015 - Gama e shërbimeve plotësohet me pikën e shitjes së materialeve të ndërtimit.
- Viti 2017 - Një fushë tjetër e veprimtarisë është hapur me Hazrolli Betonbohr- und Sägechnik GmbH.
- Viti 2018 - Në Slloveni themelohet kompania Hazrolli Group d.o.o.
- Viti 2019 - Hazrolli Group sh.p.k. themelohet për prodhimin dhe zhvillimin e produkteve të ndërtimit.



I papërsëritshmi Faik Konica

Nuk u martua kurrë, por as pa femër nuk e paramendonte jetën!

Ky beqar, i cili nuk ua tregonte kurrë moshën të tjerëve, shquhej nga të veshurit me elegancë. Mbante kostume shik blu, gri dhe të zinj, secili i shoqëruar me pallto në të njëjtën ngjyrë, por pa thile në jakë, një zakon i tij i hershëm që të mos i inkurajonte vajzat t'i ngulnin aty ndonjë lule.

Palltot nuk kishin as xhep sipër, sepse Faiku e quante jo sanitare mbajtjen e shamive për qëllime dekorative. Për të njëjtën arsye, edhe pantallonat nuk i kishte të përthyera në fund. Këmishat, të gjitha të qepura në Londër, ishin pa kopsa shtesë në mëngët, sepse, sipas tij, ato nuk luanin ndonjë rol. Jakat e këmishës i rrinin përsosmërisht drejt dhe puthitur, kravatat i zgjidhte me kujdes, rrinte gjithnjë i rruar e i qethur dhe krejt pamja e jashtme e bënte një dap-

per, siç quhen në Amerikë njerëzit, tek të cilët rëndësia nis nga veshja. Portretin e pastër ia plotësonte një nishan i madh i zi nën çipin e majtë të buzës. Ishte përgjithësisht i qeshur dhe kishte sjellje të butë, aq sa gazetaret e quatin "ministri xhentil i Shqipërisë". Tregonte gjithnjë hoborrësi, të shikonte në sy kur fliste ose kur i flisje, nuk e ngrinte kurrë zërin dhe kishte kujdes të mos i mërzieste bashkëbiseduesit me rrëfimet e tij. Ama, duke qenë interesant si tip,

shpesh bëhej qendra e vëmendjes në një rreth biseduesish, herë me anekdotat dhe herë me konstatimet e tij të mençura. Kur tymoste, hirin e shkundte me elegancë, duke goditur me dorën e djathtë gishtat e dorës së majtë që mbanin cigaren.

U SHMANGEJ GRAVE QË FLISNIN SHUMË...

Në vlerësimin e bukurisë fizike të grave Faiku ishte një katolik i



vërtetë. Pamja e jashtme e femrës, thoshte, gjithmonë duhet të vijë e dyta pas personalitetit të saj. Ndër mikeshat e shumta vlerësonte më tepër ato, të cilat natyra i kishte pajisur me inteligjencë të jashtëzakonshme dhe u shmangej grave me temperament tepër të gjallë e që flisnin shumë. I pëlqente thjeshtësia e grave amerikane, e cila, sipas tij, kishte ndikuar që modat e veshjeve në botë të bëheshin më artistike. Por, me një kusht, që ato të përdornin sandalet e të hiqnin dorë nga takat e larta. Kur në Mayflower bëhej ndonjë paradë mode, si ato që organizonte në pranverë Shoqata e Bulevardit Connecticut, ministri i Shqipërisë ishte njëri nga burrat e pranishëm. Rrinte ulur në radhët e pasme të audiencës dhe dukej po aq i interesuar në paraqitjen e stileve të çelta pranverore sa edhe gratë e shoqërisë së kryeqytetit. Megjithatë, jeta e këtij shqiptari ishte e lidhur me librat e me studimet dhe dukej se interesi i tij për gratë nuk shkonte aq larg sa ta cyste të mendonte për t'u martuar. Një korrespondenti të Washington Post-it i pat thënë: "Lulet e portokallit kanë vendin e tyre, kurse mua më jepni bibliotekën dhe muzikën, një kallamar plot me

bojë për të shkruar, si dhe të drejtën e plotë për t'u gëzuar këtyre kur dhe si të dëshiroj".

KURRË NUK DHA NJË ARSYE PËRSE NUK U MARTUA...

"Faiku", shkruante ky korrespondent, "nuk jep asnjë arsye se përse nuk martohet... por hamendja e thjeshtë të thotë se ai kupton diçka: që gratë nuk i durojnë dot dollapët plot e përplot me libra në vend të rrobave, nuk mund të shohin dot një gramafon me konin gjigant në dhomën e ndejës dhe as dorëshkrime të përhapura në dysheme".

Në shkrimet e tij Faiku nuk ka lënë ndonjë gjurmë të marrëdhënieve romantike ose martesore që mund të ketë pasur. Kjo ishte rreptësisht jeta e tij private, ku askush nuk duhet të fuste hundët.

Por, poeti dhe dramaturgu frëng, krijuesi i termit surrealizëm, Guillaume Apollinaire (Gijom Apolliner), i cili kishte pasur miqësi me Faikun, na jep këtë paragraf nga jeta intime e shokut të tij: "Në një rast tjetër, qëndrova

edhe një herë në Londër me Faik Bej Konicën, i cili ishte martuar dhe jetonte në Chingford". Fjala është për vitet e para të shekullit 20. Kur nisën polemikat me kampin e Nolit në vitin 1925 e më pas, gjithmonë gjendeshin kundërshtarë që e shanin Faikun si njeri të degjeneruar moralisht, domethënë të dhënë pas femrave.

Thuhej, madje, se ai kishte një djalë jashtë martese, të cilin e kishte lënë në Evropë. Në fillim të vitit 1938, Faiku ishte parë të takohet me aktoren e famshme të strip-tizës, 29-vjeçaren Ann Corio (An Korio) dhe menjëherë u hap fjala se ai kishte ndërmend të lidhte kurorë me të. Corio ishte një nga 12 fëmijët e një çifti emigrantësh italianë dhe ishte bërë e njohur me shfaqjet e saj në varietenë e tipit burlesque që përfshinte parodi, si dhe një dozë të mirë striptize. Në Amerikën e kohës, stripti ishte pjesa më e rëndësishme e kësaj varieteteje të përshtatur për një audiencë mashkullore. Në Uashington, teatri, në hyrje të të cilit ndriçonin dy fjalët e shkruara me neon Burlesque Burlesque ndodhej në Rrugën Nëntë. Këtu atmosfera ishte krejt e ndryshme nga rrugët e tjera aty pranë që mbizotëroheshin nga dyqanet Garfinkel dhe Hecht's.

Ilir Ikonimi

Radio,
Lajme, Moti,
Video, TV, ...

Vetëm me aplikacionin
Shkabaj për Android

ANDROID APP ON
Google play

Shkabaj
Kryja e Internetit
www.shkabaj.net



RRALLË E PËRMALLË

Ngricat dimërore ma kanë hëngër shpirtin, e sidomos në ato ditë të ftohta kur temperatura ishte minus 15 gradë celsius. Kjo edhe është arsyeja pse e dua shumë pranverën dhe vdekjen në pranverë...

PSE DUA TË VDES NË PRANVERË?

Kam filluar të mos e dua dimrin dhe nuk kisha dashur të vdisja në dimër, sepse për së gjalli po ngrihem, e për së vdekuri?!

Dimrin tash do e kisha lënë vetëm për oda: lojëra odash, takime të pleqve... E kisha lënë dimrin për ta jetuar njerëzit sikur ai dhëndri i sapomartuar, i cili, edhe pse nuk kishte më shumë se një muaj që ishte martuar, nuk e kishte ndalur shoqërimin në oda me moshatarë e pleq...

Por, nusja kishte qëlluar njëfarë dreqi dhe ia bën një kurth burrit. Kur të

Neve, shqiptarëve, tamam nuk na bie as këmisha jonë!

vije ai në shtëpi, nusja nuk do ia hapë derën dhe do të fliste me zë të lartë sikur e ka burrin aty. E, burri do të dyshonte se është në shtëpi të huaj... Dhe, ashtu ndodhi. Burri u kthye vonë pasmesnate. Trokiti në derë dhe gruaja i bërtiti:

“Kush është në derë kaq vonë?!“

“Jam unë, burri yt!“, ia ktheu.

“Unë burrin e kam këtu, por kujdes se ke hyrë në shtëpi të huaj dhe po u zgjua burri kërcet belaja!“, ia kthen ajo. Ai, meqë ishte natë, u nis te oda e kumbarës, ku e kishte kaluar natën. Kumbara doli nga oda me mendjen se mund të ketë harruar diçka dhëndri i ri. Por, kur i tregoi se çka i kishte ndodhur, kumbara i tha që të shkojnë bashkë në shtëpinë e tij...

BURRI IM ECË SI DREQI ME NJË KËMBË!

Dhe, kur arritën te shtëpia e tij, u afruan afër derës dhe, pasi nuk dëgjuan

zë, kumbara trokiti në derë.

“Nuse, hape derën se ta solla burrin!“, i tha kumbara.

“Kumbarë, burrin e kam këtu, në shtëpi“, i tha, teksa e shikonte nga një kënd i dritares burrin e saj që qëndronte me një këmbë pranë derës dhe vazhdoi: “Kumbarë, shiko mirë me kënd je! Nëse është duke qëndruar me një këmbë, dije se është dreqi, e jo burri im!“

Kumbara, kur e pa që, vërtet, ai po rrinte me një këmbë, iku nga ai, duke menduar se ishte me djallin... E, dhëndri, meqë nuk mund ta kalonte natën në prag të derës nga të ftohtit, shkoi dhe ra mbi kashtë në pleme... Në mëngjes, kur u zgjua, pa se oxhaku po tymonte dhe ia mësyri shtëpisë, sepse tash e dinte se dera veç do ishte e hapur. Kur hyri brenda, u turr te oxhaku për t’u ngrohur...

Nusja i tha:

“A shkon më në oda natën?!“

“Shkon burri, shkon!“, ia ktheu ai me

njëfarë krenarie.

“Shkon, a?! Por, fle në pleme, në kashtë!”, ia ktheu gruaja.

Dhe, teksa e kujtoj këtë histori, shoh një veturë dhe pas saj disa burra e gra që i shkojnë pas.

Vetura po ecte ngadalë, duke bartur një arkivol për te varrezat.

“Oh, Zot, sa keq që ka vdekur në dimër ky njeri!”, them me vete dhe vazhdova: “Ka qenë, me siguri, ndjellakeqes, e i ka marrë në qafë gjithë këta burra e gra pas vetes!”.

NË DIMËR AS POLITIKA E AS ZGJEDHJET NUK KANË SHIJE!

Dhe, teksa e çojnë te varrezat të vdekurin në dimër, mendoj se në dimër edhe politika është pashije. Sepse, edhe zgjedhjet e sivjetme qenë në dimër dhe shumë pak njerëz dolën në votime, sidomos të moshuarit, sepse në atë të diel të zgjedhjeve ishte shumë ftohtë...

Andaj, nuk kanë faj që i lënë zgjedhjet në pranverë apo vjeshtë. Pra, as kur është ftohtë, e as kur bën tepër vapë. Por, në stinët kur klima është tamam, edhe pse neve, shqiptarëve, tamam nuk na bie asgjë, madje as këmisha jonë!

Dhe, mendja më shkon te protestat e vitit 1981 kundër Serbisë. Ato i kemi bërë në pranverë, sepse më lehtë ka qenë të protestohet e demonstrohet, sesa të ishte dimër e njerëzit nga acari të ngurronin të dilnin në rrugë...

VEÇ KUR NXEHET MOTI FLITET PËR HEQJEN E VIZAVE!

Dhe, shqyr që tash jemi në pranverë dhe përsëri do nisë të flitet për vizat, sepse edhe është stina të flitet për tema të nxehta...

Edhe sivjet, si edhe viteve të tjera, posa u ngrohë koha dola mbi majën e kodrës së “Surxhukut”, që t’më kapnin rrezet sa më mirë, sepse trupit në këtë kohë pandemie, më shumë se asnjëherë më parë, i nevojitet vitamina D.

Kthej kokën kah dielli dhe i them: “O diell i bekuar, ti je ai që më ke ngrohur edhe në fëmijëri! Dhe, deri më tash vetëm ti nuk ke ndryshuar, je po ai që ishe, je po ai që na ngrohe dhe po na ngrohë, sepse politika nga ka mërdhirë sivjet në zgjedhjet me acar!”.

Në këtë moment vjen një njeri dhe më thotë se është xhebraili dhe më sjell lajmin se duhet të vdes, meqë është stina ime e preferuar...

Por, për fat, në çast më del gjumi, e që trupi më ishte dërmuar në shtrat...

“Faleminderit Zot, që paskam qenë ëndërr! Se, përndryshe, deri më tash xhebraili do ma kishte marrë shpirtin!”, e solla në mendje.

S. M.



Të çmendurit e Kosovës

“Këtyre s’ka çka u bën as Shkupil!”, kështu deklarojnë qytetarët, kur i shohin të çmendurit e Prishtinës, të cilët lëvizin të lirë rrugëve pa i penguar askush.

Sidoqoftë, numri i të sëmurëve mendorë është rritur me të madhe menjëherë pas lufte, e tash edhe në këtë kohë pandemie dhe kjo vërehet qartë. Në pyetjen pse kosovarët po prekën shumë nga sëmundjet e rënda mendore, përgjigjet e mjekëve janë: “Dikur ishin pasojat e luftës. Tash pasojat e pandemisë!”.

Sidoqoftë, është për të të ardhur keq kur sheh njerëz të

çmendur që bredhin rrugëve. Kjo është pamje e rëndë dhe shumë prekëse. Madje, as lypësit nuk të të prekin më shumë sesa të sëmurët mentalë.

Pastaj, rreziku po rritet, sepse ata i kanë edhe ditët e tyre të këqija, kurse viktimat janë vajzat e reja, e që pësojnë nga veprimet e tyre të këqija, herëherë edhe të rrezikshme. E, sa dimë, as policia s’ka çka u bën, sepse nuk ka ligj që i mbron të çmendurit apo edhe ndonjë vend ku mund të trajtohen, siç janë sanatorimet e ndryshme në shtete të ndryshme të botës.

Nga notesi im...



*Iku nga jeta.
Kështu mund të
thuhet për Cimën,
e që ndërroi jetë
para ca ditësh.
Por, Cimën e
bënte edhe më të
madh Leci. E, Lecit
askush s'i bëri
nderime shtetërore
kur shkoi nga kjo
jetë...*

Humorin "Treshi përsheshi" e bënte interesant Leci. Ai shkoi në amshim para ca vitesh, e tash shkoi edhe Cima.

Por, para do vjetësh shkoi në amshim edhe Cani, që kishte role me të dytë.

Dhe, kur dikush, si këta artistë, ndërron jetë, disi je në mëdyshje që kanë vdekur, sepse tërë jetën i kemi parë vetëm duke qeshur... Sidoqoftë, humoristi kosovar, Rasim Thaçi, la pas vetes një karrierë të artë humori. Nuk është se edhe humoristët tjerë nuk ditën të bëjnë humor, por Cima e mbajti gjallë humorin në kohën kur njerëzit tanë buzëqeshjen e kishin fals, sepse koha punonte kundër tyre. Serbia në vitet 90 e mbylli Televizionin e Prishtinës, e që ishte i vetmi. Dhe, mbetëm të kënaqemi me videokasetat që nxirrnin në treg "Treshi Përsheshi" ynë i njohur. Në një rast, kur Cima shkon në një audicion, regjisori e pyet: "Çka di ti, Cimë?".

"Di me u shti me qeshë, por di me u shti edhe me qarë..."

Sidoqoftë, Cima nuk jeton më, por vepra e tij nuk do të harrohet kurrë...

Safet Krivaça

Një lot për dhembje



Pillaka përkujtimore në qendër të fshatit Mushtisht

Mushtishti, fshati i këngëtareve nacionaliste

Në Mushtisht të Suharekës dominuan këngët e para nacionaliste, kënduar nga të rejat e asaj kohe: Shkurte Fejza, Shyhrete Behluli, më vonë Remzie Osmani e motrat Mustafa, në kuadër të Shoqërisë Kulturore-Artistike "Afërdita", shoqëri e cila kontribuoi në mbajtjen e identitetit kombëtar, sidomos pas vitit 1981, kur edhe bëheshin përpjekje të vazhdueshme nga Serbia që të rrënohej çdo gjë që ishte me vlerë kombëtare shqiptare.

Mushtishti, si rrallë ndonjë fshat në Kosovë, njihet për shumë këngëtare të njohura që kanë pasur sukses në skenën e artit muzikor. Në Mushtisht thonë se këngëtarët e këtij fshati kanë krijuar çdo herë ambient nationalist për të mirën e kombit dhe kjo i kishte çmendur serbët lokalë dhe më gjerë. Nga zëri i tyre janë tmerruar serbët, sepse ato, vërtet, e këndonin me ndjenja këngën patriotike. Demonstratat e vitit 1981 nxorën në pah shpirtin gjakpirës serb në këtë fshat. Megjithatë, nacionalizmi dhe shovinizmi serb në Mushtisht u pa më së miri në vitin 1990, kur definitivisht nxënësit shqiptarë u përjashtuan nga shkolla dhe në shkollë mbetën të mësojnë vetëm nxënësit serbë të fshatit. Fshati që ka pësuar 22 viktima gjatë luftës së vitit 1999, vlerësohet se kjo shifër është minimumi i asaj që ishte pritur. Në pllakën përkujtimore të vendosur në qendër të fshatit, figuron ekspozita e shumë pamjeve të tmerrit që lanë pas vetes serbët, kur edhe ikën nga

Mushtishti.

Në mesin e këtyre pamjeve është edhe një grua e moshuar, të cilën paramilitarët serbë, pasi ia hodhën trutë në tokë me kondak pushke, e vranë me rafal automatiku dhe më pas e dogjën në dalje të fshatit. Sidoqoftë, Mushtishti është fshat i kurbetçinjve. Prej 800 familjeve sa ka sot Mushtishti, nuk besohet të ketë ndonjë familje që nuk e ka dikë në kurbet. Ata, kryesisht, jetojnë dhe punojnë në Zvicër.



Shkurte Fejza në Festivalin "Mushtisht 1974"



Shyhrete Behluli në Festivalin "Mushtisht 1974"

Vlera Jusufi bukurinë dhe talentin e ka nga Zoti

Vlera Jusufi është ndër prezantueset më të bukura, më të talentuara dhe më të afirmuara në ekranet tona televizive, meqë punoi në disa televizione, kurse tash është pjesë e ATV-së.

Karrierën e prezantueses e filloi që e re dhe vazhdoi ta përsosë aq sa sot dallohet nga prezantueset tjera në ekranet tona. Sepse, me pamjen engjëjlore, prezantimin e ëmbël e korrekt, Vlera i bëri vend vetes në botën e televizionit, duke u bërë mjaft e preferuar për publikun. Ajo, madje, prezantoi edhe sportin në TV. Në fakt, ajo ka vite që është martuar me ish-futbollistin e shumë klubeve të ndryshme, Enis Fetahun. E, Enisi, si duket, e ka ndihmuar shumë në krijimin e një moderatoreje të suksesshme sportive. Pra, jo rastësisht ka

qenë e përfshirë edhe në emisionet e sportit. Sepse, të jesh gruaja e ikonës së futbollit, Enis Fetahun, e të mos jesh në një farë mënyre "brenda" sportit, është e pamundur. Ndërkaq, tash është pjesë e Televizionit ATV, me emisionin "E vlen të dielën", në të cilin emision prezanton kuzhinierë të dalluar, këngëtarë të veçantë dhe pjesëmarrës të tjerë që zgjojnë kureshtjen për t'i ndjekur në ekran. Veçmas, sharmi i saj prej prezantueseje dhe e folmja e pastër të bëjnë ta adhurosh, deshe a nuk deshe...

BOOM

Vera Qollaku

*punën e ka profesion
dhe pasion*

Si i zbulon të fshehtat
e VIP-ave Amir Mjeku?

Kaltrina Selimi
kurrë nuk bëhet bajat

Çfarë operacionesh
bëri në fytyrë

Robert Berisha?

Cilat këngëtare
këndonin në festivale,
e tash këndojnë tallave?

Vera Qollaku është emër i njohur i fushës së bukurisë në Zvicër, meqë prej vitesh e ka sallonin tashmë të famshëm “Beautynailsvera”. Është model i femrës punëtore, kreative e tejet profesionale dhe, falë të gjitha këtyre elementeve, ia ka dalë që të jetë kjo që është - Vera e shërbimeve të klasit të parë.

Në sallonin e Verës, me metodat më efikase bashkëkohore, bëhet mbjellja e thonjve, qerpikëve, kthimi i qerpikëve, botoks për flokët, pedikyr, ngjyrosja dhe prerja e vetullave, zgjatja e flokëve, stilimi i flokëve, make-up profesional etj.

Në “Kosovare” një rrëfim ndryshe i Vera Qollakut, si imazh i “Boom”-it...



Vera Qollaku

punën e ka profesion dhe pasion

Verë, na e prezanto veten me disa fjali?

- Jam me prejardhje nga Kosova, por jetoj dhe punoj në Cyrih të Zvicrës. Jam femra më me fat, sepse Zoti më ka dhuruar tre fëmijë dhe bashkëshortin e mrekullueshëm, pa përkrahjen dhe ndihmën e të cilit nuk do të isha këtu ku jam sot.

Si e kujton fëmijërinë tënde, jetën e dikurshme?

- Kam pasur fëmijëri të bukur. Kam qenë e rrethuar me shumë dashuri dhe njerëzit e dashur më kanë falur shumë momente të paharruara...

Kur ishe fëmijë, a doje të ishe kjo që je sot?

- Po, përherë kam ëndërruar që një ditë të jem femër e pavarur dhe me punën time t'i bëj të lumtura edhe femrat e tjera. Fatmirësisht, puna që bëj është edhe pasioni im.

Për ata që nuk e dinë, me çka merresh sot dhe cili është pasioni yt?

- Kam sallonin tim të bukurisë në Cyrih dhe aty jam çdo ditë. Punoj me thonj, qerpikë dhe mbajë kurse për vajza të reja, të cilat duan të aftësohen profesionalisht.

Çka të pëlqen më tepër nga zanati yt?

- Të gjitha shërbimet që ofrohen në sallonin tim i realizoj me shumë dëshirë, pasion e përkushtim. Punën e bëj me zemër dhe ky mendoj se është çelësi i suksesit. Nuk mund ta ndaj asnjë shërbim.

I zbukuroni të tjerat. Çfarë ndjenje është kur ia arrin qëllimit?

- Ndenja më e bukur e më

briljante kur i shoh klientet e mija duke dalë nga studio të buzëqeshura, të kënaqura dhe me shumë falënderime. Është ndjenjë e papërshkrueshme...

Po ty, kush ose çka të zbukuron?

- Jeta e qetë, e mirë, por edhe duart e mija. Rregullohem vetë, pasi e bëj këtë punë edhe profesionalisht.

Kemi dëgjuar se shëtit shumë, e shijon jetën. E, cili është hobi a pasioni yt?

- Jeta më ka dhënë të mira, për çka jam falënderuese. Pasioni im është vetë puna ime.

Lidhja jote me Kosovën a është e fortë?

- Po. Unë rrjedh nga një familje e madhe. Andaj, njerëzit më të dashur e më të shtrenjtë i kam në Kosovë. Dhe, nuk thonë kot: S'ka si vendi yt!

A do të kërkoje më shumë nga jeta?

- Kam familje të mrekullueshme dhe kjo më bën të jem e lumtur. Jam e rrethuar nga njerëz që i dua e më duan. Dhe, çka do kërkoja më shumë nga jeta?


Planet tua profesionale janë...?

- Kam shumë plane, projekte. Ndër të tjerash, është linja ime që tashmë e kam realizuar, konkretisht shampoo "Beautynailsvera", të cilin klientet mund ta blejnë në sallonin tim. Së shpejti do i publikoj edhe projektet tjera me rëndësi...

Një mesazh për fund?

- Të gjitha femrave u them të mos ndalen në arritjen e qëllimeve të tyre...

N. N.



Personazhe në sytë e... Amir Mjekut

Si i zbulon të fshehtat e VIP-ave Amir Mjeku?

FLORI MUMAJESI

Flori është njëri nga kantautorët shqiptarë më të zotët dhe që arrin ta nuhasë mirë atë çka kërkohet, prandaj edhe sukseset nuk i mungojnë.

Megjithatë, kam një eksperiencë jo të mirë sa i përket intervistave me Florin, shkaku i mënyrës se si ishte përgjigjur në një pyetje që ia kisha bërë në kohën kur flitej për ndarjen e tij nga Soni Malaj. Unë mendoj se zgjuarsia është atëherë kur di dhe me shumë maturi jep përgjigje ashtu siç do ti, madje edhe atëherë kur nuk dëshiron të flasësh për një çështje të caktuar.

E, Flori, jo që nuk di ta bëjë këtë, por para disa vitesh ishte ndryshe...

Mirëpo, për muzikë, patjetër, duhet me ia zgjatur dorën!

ARBANA OSMANI

Për mua Arbana është prezantuesja më e mirë shqiptare. Kam një eksperiencë shumë të mirë nga një emision që pata realizuar disa vite më herët me të. Dhe, përtej asaj që e kisha parë në televizor, më pat lënë shumë përshtypje të mirë edhe si person: komunikuese, e hapur, mikpritëse dhe tejet e kujdesshme.

GETOAR SELIMI

Nuk po më pëlqen fakti se viteve të fundit po i neglizhon mediet në Kosovë dhe është më i pranishëm në ato të Shqipërisë! Por, Geti dhe disa të tjerë, e që po mundohen ta bëjnë këtë, mos të harrojnë se atëherë kur rrjetet sociale nuk e kishin peshën që e kanë sot, ishin pikërisht mediet në Kosovë që i promovonin dhe, kështu, edhe falë tyre janë këtu ku janë sot.



ULPIANA LAMA

Femër e kompletuar. Me të mund të flasësh për çka do dhe kjo më pëlqen shumë. Do të ishte mirë që të kishim më shumë personazhe të tilla publike.

VALDRIN SAHITI

Valdrini është një disajner që ka dëshmuar se me punë dhe mund arrin atë çka dëshiron. Andaj, sot është një prej emrave më të kërkuar në botën e modës te ne dhe këtë e tregojnë edhe bashkëpunimet e shumta me emra mjaft të suksesshëm. Ndërkohë, e çmoj shumë edhe faktin se në intervista është i drejtpërdrejtë, flet pa frikë atë çka, vërtet, e mendon dhe di gjithmonë ta mbrojë punën e vet.

Nderim Neziri

Amir Mjeku është gazetari dhe prezantuesi i njohur, e që vite me radhë ka sjellë në ekran formate shumë të ndjekura televizive. Ai është producent i emisionit të mëngjesit dhe së shpejti do vjen me projektin e radhës që do të titullohet "Tension". Por, a është ai vetë në tension, teksa flet për personazhet e famshëm?



Kaltrina Selimi *kurrë nuk bëhet bajat*

Kaltrina Selimi është nga ato këngëtare që kurrë nuk bëhen bajat. Por, kohëve të fundit, megjithatë, po i mungon skenës muzikore. Ama, njerëzit e mbajnë në mend atë dhe këngët e saj.

Këngëtarja e mirënjohur është martuar dhe vazhdon të ndihet plotësisht e dashuruar. Ç'thotë Kaltrina për dashurinë?

“Dashuria, si në jetën e çdo njeriu, ashtu edhe timen, është një gjë shumë e madhe dhe pa të jeta ime do ishte e mangët. Jam shumë e lumtur që e kam gjetur...”.

Sidoqoftë, Kaltrina ka një martesë të lumtur me bashkëshortin, Dritonin, të cilin e njohu para shumë vitesh në Ulqin, derisa ajo ishte në pushim veror.



Cilat këngëtare këndonin në festivale e tash këndojnë tallave?

Shumë nga emrat e njohur të skenës tashmë i janë "gjuajtur" tallavesë, sepse aty është paraja. Duket e pabesueshme kur dëgjon tash këngëtare që këndojnë në restorante, kafene e dasma këngë të zhanrit folk-tallave, e që dikur ishin ndër më të mirat në festivalet e kohës... Cilat janë ato?



ALBËRIE HADËRGJONAJ

Albëria, këngëtarja e vlerave, zëri i fuqishëm, fituesja e festivalit të madh, tashmë e ka gjetur rrugën e saj. Albëria po e shfrytëzon në maksimum dëshirën e publikut për muzikë tallave...

Ata që e dëgjojnë interpretimin e Albërisë, thonë se ajo krijon atmosferë, andaj jo rastësisht është shumë e kërkuar...



RYVA KAJTAZI

Nisi me pjesëmarrje në festivale, vazhdoi me videoklipe moderne e këngë të bukura pop, por shpejt e kuptoi se për të bërë gjëra të tilla duhet investim i madh e fitimi nuk ishte askund...

Dhe, Ryva e "ndërroi" pllakën, duke i hyrë tregut të dasmave. Madje, shpesh këndon edhe tallave!



MIMOZA SHKODRA

Kushdo që e dëgjon thotë se ka zë të mirë. Kushdo që e sheh thotë se duket bukur.

Pra, kjo është Mimoza Shkodra, e që, ndonëse është aq moderne, nuk i ndahet asnjëherë tallavesë...

Mimoza fiton në tallave e investon në këngë e videoklipe që e ngritin imazhin e saj si këngëtare...



ARTA BAJRAMI

Avangardja e skenës muzikore, promovuesja e RNB-së, tashmë ka ndryshuar. Arta ka dalë nga linja e dikurshme, duke e komercializuar dukshëm krijimtarinë e saj muzikore.

Këngëtarja e shumë hiteve, tashmë i është qasur dasmave, ku edhe fiton mirë. Ajo ja thotë pa problem edhe tallavesë...



TEUTA SELIMI

Talenti i saj në muzikës është i pamohueshëm, meqë Teuta Selimi ka dëshmuar prej kohësh se di të këndojë dhe ka potencial në këtë fushë.

Fillimisht erdhi në skenë me diçka regge, për çka u cilësua si tejet moderne, por më pas e pa që nga ai zhanër nuk ka gjë. Sepse, paraja është diku tjetër, te muzika folk, tallave.

Andaj, tash Teuta nuk ndalet së kënduari tallave dhe këtë e pranon publikisht...

N.

Çfarë operacionesh bëri në fytyrë Robert Berisha?



Tani edhe meshkujt kanë filluar ta synojnë perfeksionin në pamjen e jashtme. Kjo realizohet edhe falë ndërhyrjeve të ndryshme. Dikush i mbjellë flokët, dikush i heqë rrudhat, i frynë buzët etj...

Robert Berisha ndër vite ka ndryshuar shumë. Ndonëse në të 40-at, duket ende i freskët, i pashëm.

Roberti ka hyrë tashmë në listën e meshkujve të njohur me ndërhyrje estetike, pasi përmes disa postimeve ka treguar se i viziton qendrat estetike për të korrektuar pamjen e jashtme.

Roberti vazhdon të mbajë emisionin me titull "Robi plaket kur do vetë" dhe, gjithashtu, përfillet shumë për jetën private...



I ndodhur në pjesën më të bukur në zemër të Brezovicës larg nga zhurma dhe nxitimi i qytetit, hoteli është i vendosur në një pjesë magjepsëse dhe të qetë të rrethuar nga malet e Sharrit dhe pranë Lumit Lepenc.

I ndërtuar me një arkitekturë të veçantë dhe magjepsëse, që të bën të ndjesh një qetësi shpirtërore, me një shërbim profesional që ruan standardet, e që në qendër të vëmendjes ka mysafirin, Hoteli posedon 72 dhoma të mobiluara me një stil luksoz modern, ku shumica e tyre ofrojnë pamje spektakolare mbi gjithë perlën e Brezovicës.

Këtu mysafirët do të ndihen komfort dhe të plotësuar. Hoteli ofron Restorantin Gjethja, Opera Cafe Bar, Magnet Night Club, sallat e takimeve dhe konferencave si dhe Aquarius Spa Center.

Gjatë stinës së dimrit, mysafirët mund bëjnë skijim, ngjitje në male dhe aktivitete tjera dimërore.





Ku është Hamami i Hyrës?

E fillova në Zagreb dhe e përfundova te gruaja ime pse nuk sheh ëndrra. Ishte një ëndërr që përfundoi, në realitet, jo bash e mirë. E, të gjithë jemi pjesë e këtij realiteti: edhe të mençurit, edhe budallenjtë.

PËR ÇUDI:

AS NUK VDIQ KUSH, AS NUK U SËMURË KUSH!

E kisha lënë për nesër takimin për kafënë e mëngjesit me atë që e kisha pritur më shumë se dhjetë vjet. Vinte nga larg në Prishtinë dhe doja ta shihja me sy, meqë kishim shkruar gjatë e gjatë, me vite e vite. Nata po vinte. Bëra një dush në banjë dhe bëra shumëçka që për nesër të dukem sa më bukur. Më doli gjumi dy orë para mesnate dhe u befasova për të parën herë në jetë se si nuk më doli asgjë këtë natë të ma prish të nesërmen: As nuk vdiq askush, as nuk u sëmurë askush! Uh, jetë o jetë, sa bukur kur nuk të prishet e nesërmja, sa mirë kur të thyhen parandjenjat e liga...

AH, PO TA KISHA

FUQINË E XHA AJETIT, ME DORËN SA PARAJKA!

Dal në ballkon dhe krejt çka ka me shpirt jashtë është një mace e fqinjëve, që loz mbi barin e oborrit, duke u ngjitur në blirin para shtëpisë. Më heton, ndalet e më shikon. Më shikon ajo, por e shikoj edhe unë dhe më duket sikur më thotë: "Ende nuk është për "morgen", njeri, kthehu fle akoma e mos më shiko mua!". E mbylli derën e tarracës dhe kthehem në shtrat, i gëzuar që erdhi gati agu dhe dita nuk më ishte prishur me asgjë. Duhet të ketë qenë ora 6 e mëngjesit kur hajnat ma kishin

thyer veturën. Isha në Zagreb. Pesë vetë sillen rreth veturës sime. "Ej, çka bëni këtu, o burra?!". "A është kjo e jotja?". "Kush u ka thënë ta hapni veturën? Jeni hajna ju apo njerëz të shtetit?". "Jemi si në mes diçka...", më thotë njëri nga ta. "Kjo veturë sikur nuk është e jotja", më thotë tjetri. "I kam letrat në veturë që të bindeni ju se është imja". "Të besojmë ne, të besojmë...", më thotë tjetri. "T'më kishit besuar, me siguri, nuk do e hapni, por unë dua që të verifikoj kush jeni ju. Nuk i hipi veturës pa ditur se kush jeni ju dhe nëse keni marrë diçka apo

keni lënë në veturë. Gjatë rrugës mund t'më ndaloj ndokush e t'më kontrolloj...".

"Jo, ore, mos shko larg!", më thotë njëri.

"Dua të shkoj larg, sepse kështu ma keni bërë punën".

Dhe, më shkon në mendje ta rrah njërin, por çka do u bëj katër të tjerëve? Eh, sikur ta kisha trupin e xha Ajetit, që ka vdekur para pesëdhjetë vjetësh! Ka qenë i madh me trup. E kishte dorën sa një parajkë dhe i gjatë diku mbi dy metra.

Para se të vdiste, njëri e pyeti:

"Si je, he burrë? Mos u dorëzo, sepse gjithnjë ke qenë i fuqishëm dhe durimtar!".

"Keq. Keq shumë. Nuk më ka mbetur fuqi as për dy vetë! Nuk jam ai që isha, si kam qenë. Vdekja po më troket te dera, shpejt do të shkoj".

Edhe unë, të kisha qenë si xha Ajeti, e t'i kisha rrahur ata pesë vetë, do të kishte qenë mirë, por duhet të merrem vesh me ta me të mirë, aq sa mundem. Sepse, me të fortin kur nuk mundesh, duhet të bësh kompromis. Diçka si mes Kosovës dhe Serbisë, që nuk po merren vesh ndërmjet veti, por po ua presin teshat ata në Bruksel!

"Çka të bëj?", pyes veten.

"Më mirë ta thërras ndonjë polic e t'i verifikojnë këta njerëz që flasin herë shqip e herë serbisht".

Por, në rrugë nuk lëviz njeri me uniformë polici. Më në fund, ata tërhiqen dhe shkojnë. Dhe, pasi largohen, në kokë më vijnë shumë ide...

Si nuk ua bëra nga një foto me telefon celular, bre?!

SHYQYR QË NUK E KISHA ME VETE GRUAN, SEPSE DO MA VIDHNIN!

Dhe, derisa i bëj vetes këtë pyetje, kalojnë disa policë dhe njëri prej tyre më pyet: "A të duhet gjë?".

"Hamami i Hyrës!", i them.

"Kush është ajo Hyrë?", pyeti polici.

"Hyra është e hamamit të Gjilanit. Por, lëre tani atë punë se shumë jeni vonuar, e ku t'i gjej tash ata që e kishin hapur veturën time?!". "A ke pasur gjë në të?".

"Jo, nuk kisha. Më e mira që sot nuk e kisha me vete as gruan, se mund t'ma kishin rrëmbyer!".

Dhe, zgjahem nga shtrati i shokuar nga ëndrra e mëngjesit. Ëndrrat e mëngjesit qenkan më të trishtuara se ato të natës. Andaj, shpresoj të mos më përsëritet më ajo ëndërr. Shpresoj në ditë të bukur, por cili është, a thua, kuptimi i ëndrrës?

Me siguri, do të jetë ditë e bukur dhe e mirë. Kam dëgjuar se kur sheh uniformë, ëndrra del e mirë dhe po e lë me kaq.

GRUAJA IME IA FUTË GJUMË DHE S'E KA GAJLE A FRYNË ERA A JO!

Për çudi, gruaja ime nuk sheh kurrë ëndrra! Dhe, mirë e ka, ja fut gjumë dhe kur e pyes se a e ka ndie erën e fortë që ka fry natën, thotë: "Jo more, çfarë ere, a ëndërr je a?!".

As nuk sheh ëndrra, as nuk e prishë gjumin, as nuk e prishë të nesërmen... "Heu, po mirë", them me vete, tek fle ajo me një gërhisje që ndihet, ndoshta, edhe te fqinji që sapo e pash ëndërr.

Sokol Murturi

Në vend të përkujtimit

Enciklopedia e quajtur Shaqir Hoti



Ditë më parë vdiq mjeshtri i muzikës burimore shqipe, Shaqir Hoti. Ai ishte i vetmi në trojet shqiptare, i cili ekzekutoi me të gjitha instrumentet me frymë.

Shaqir Hoti jetën e kaloi në skenë, por edhe në dasma e ahengje të tjera. Ai ishte enciklopedia e vetme burimore shqipe që ekzekutoi në 10 instrumente muzikore dhe në çdo njërin ishte i pazëvendësueshëm si artist. I lindur në vitin 1936 në Rogovë të Hasit të Prizrenit, u rritë me fyell në dorë. Ishte shkolluar për flaut, por me mjeshtri ekzekutoi të gjitha instrumentet muzikore me frymë dhe në këtë pikë nuk ia kaloi askush.

Orkestrës së Radio Prishtinës i mungonte një flautist dhe këtë vend do ta mbulonte vetëm Shaqir Hoti.

"Pata fatin të inkuadrohesha shumë lehtë në orkestër, edhe pse në atë kohë filluan disa probleme me njerëzit e komitetit për punë ideologjike", pat thënë, veç të tjerash, në intervistën tonë të botuar në vazhdimë në "Kosovarja" numër 21, 22 dhe 23/2005.

Ai me orkestrën e Radio Prishtinës mori pjesë edhe në shumë festivale të ndryshme, por edhe në dasma e ahengje të ndryshme si në Kosovë, në SHBA e gjetiu. Madje, ishte edhe në Rezidencën e të madhit Fan Noli.

S.

*Qershor 1990.
Sllovenia i bënte
përpyjekjet e fundit
që të shpallte pa-
varësinë. Redaksia
më caktoi mua dhe
Enverin, fotoreport-
er, të shkonim në
Lubjanë, për t'i bërë
disa reportazhe për
shqiptarët që jeto-
nin dhe punonin
në këtë qytet, e që,
me numër ishin, pa
dyshim, mijëra sish.
Por, edhe një repor-
tazh reklamues, me
kërkesën e një firme
sllovene në vendba-
nimin Shkocjan.*

Në hotelin ku u vendosëm afër qen-
drës, ndodhej parku. Pasi pushuam
pak në hotel, në mbrëmje dolëm të
shëtisim, më shumë që t'i shijonim
pamjet e bukura e të pastra të Lubja-
nës.

Atje ku përfundonte parku i madh,
në një skutë, ndodhej një barakë e
gjatë, me shumë dritare të vjetra. Në
çast, mendja më shkoi se në to flenë
shqiptarët...

Dhe, kur i afrohem, gjithsecilit i
flisnim shqip, sepse edhe me pamjet
e fytyrës e të veshjes ishin tamam
shqiptarë.

Atë natë, deri kah mesnata, në njërën
nga dhomat e barakës pimë çaj, si në
odat tona në Kosovë. Por, kureshtja
që të qëndroja edhe më gjatë me ta
dhe të mësoja shumëçka për jetën
dhe punët që bënin ata në Lubjanë,
nuk më linte të ngriheshim, e që disa
prej tyre, nga lodhja dhe puna e rëndë
gjatë ditës, veç filluan të koteshin...



Drenicaku picës i thotë lakror!

SHQIPTARËT KANË PARA...

Të nesërmen e lëshuam Lubjanën
dhe u nisëm drejt Portorozhit, meqë
nja 50 kilometra larg Lubjanës, në
Shkocjan, edhe ishte caku tjetër yni
që të bënim një reportazh reklamues
të një firme me shtypshkronjë shumë
moderne, pronar i së cilës ishte një
kroate, e interesuar ta shiste pronën
e vet, meqë Sllovenia veç sa nuk e
kishte shpallur pavarësinë, e lufta, pa
mëdyshje, ishte e pashmangshme.
Dhe, pasi e gjetëm firmën që
kërkonte t'i bëhej reklama në revistën
tonë, në një fshat malor si Brezovica
jonë e bukur, pronarja na priti me
dashamirësi.

Pa hyrë në hollësi i them:

"Pse dëshironi të reklamoni te ne, në
Kosovë?"

Ajo ma ktheu:

"Ju, në Kosovë, keni para. Shumë më
shumë kanë shqiptarët që jetojnë në
Zvicër e Gjermani. Kështu jam e infor-
muar... Vetëm ju mund ta blini këtë
pronë të bukur e të shtrenjtë..."

Dhe, pasi i mora shënimet e nevo-
jshme, por edhe Enveri i bëri foto-
grafitë që mendonte se ishin të nevo-
jshme për ilustrim, u nisëm rrugës që
çonte në bregdet, në Portorozh, e që
duhej t'i kalonim edhe 60 kilometra
për të arritur atje.

A HAHEN PICAT?

Pas një rruge mjaft të mundimshme,
e me kthesa të mëdha maleve, në
një kthesë hasëm në një tabelë "Kafe
restorant 1 km". Dhe, thënë të dre-
jtën, na u bë qejfi, jo vetëm që do të
ngrinin diçka, por kishim nevojë edhe
për pak pushim.

Në restorant, për çudi, nuk ndodhej
asnjë njeri, përveç kamerieres së re, e
cila, me veshjen e saj provokuese, nuk
të linte përshtypjen se ishte punëtore
e restorantit.

Posa u ulëm, erdhi afër nesh dhe na
pyeti: "Urdhëroni, çka doni të pini?"

"Së pari, kemi nevojë të hamë. Çka
keni për të ngrënë?", i tha Enveri.

"Kemi piza. Doni t'ua bëj nga një?", foli
me një qeshje të lehtë.

"Mirë. Por, na sjellë edhe nga një birrë
", ia ktheu Enveri.

"Enver, çka është piza? A hahet?", i
thashë.

"Nuk di! S'kam ngrënë kurrë", ma
ktheu.

Dhe, në çastin kur kamerierja na i solli
birrat, e pyeta: "A hahen pizat?"

"Po, janë shumë të mira. Për 10 minuta
do jenë gati, foli ajo dhe u largua.

Kur i solli pizat, i them Enverit:

"Provoje, a hahet a jo!?"

Ai mori një kafshatë, pastaj një tjetër
dhe më tha:

"Ha se po të kënaqka... Qenka laknur".

Isa ILAZI

AGE STOP SWITZERLAND

NE JU SJELLIM LËKURË TË BUKUR PËRJETË...

LINJË ZVICERANE PREMIUM

Produktet tona janë të prodhuara 100% në Zvicër dhe kanë për qëllim të sjellin më të mirën në shkencën e anti-age, bazuar në zbulimet revolucionare të Swiss Snow Algae dhe nismës së Plant Stem Cell Research.



BENEFITET E PRODUKTEVE:

- ✓Rrisin elasticitetin dhe qëndrueshmërinë e lëkurës
- ✓Largojnë rrudhat e thella dhe linjat e imëta
- ✓Promovojnë lëkurë më të re
- ✓Rigjallërojnë dhe mbrojnë lëkurën në nivel qelizor
- ✓Riparojnë lëkurën në menyre aktive me teknologjinë Bio Mimetic Peptide

INGREDIENTËT

AGESTOP SWITZERLAND prodhon produkte të kujdesit ndaj lëkurës, të standardeve jashtëzakonisht të larta të cilësive duke përdorur përbërës zvicëranë të provuar shkencërisht dhe të vlerësuar ndërkombëtarisht dhe të fitues të çmimeve të ndryshme/ teknologji të avancuar formulash - pioniere në Stem Cell, Peptide, Bio Mimetic dhe Cellular Renewal Science për të gjitha llojet e lëkurës, racave, moshave dhe gjinitë.





Një ngjarje që e tronditi Kaçanikun në vitet 70

Axhib Tusha, profesor, e që jetonte në lagjen time, të dashurën e kishte mësuese. Por, pasi u bënë prindër të një fëmije, u ndanë. Gjyqi mbahej në Kaçanik. U dha lajmi: “U prishën ndërmjet veti!”. Dhe, për këtë ngjarje mori vesh tërë Kosova...

Në vitet 70, atëherë kur të rrallë ishin çiftet që në rrugë shiheshin dorë për dorë, profesori, fqinj imi, bënte një jetë lumtur me të dashurën e tij - mësuese. Por, edhe pse ata u bënë me fëmijë, erdhi te ndarja e tyre... E, kur morëm vesh që profesori me mësuesen u ndanë, na u dhimbsën shumë...

Divorci mes tyre na bëri me lot. Sepse, në atë kohë ndarjet ishin shumë të rralla dhe nuk ndodheshin pa ndonjë arsye të madhe. E, aq më keq kur çifti ishte edhe me fëmijë...

EDHE ÇIFTI I LUMTUR PO U NDAKE!

Ka kaluar shumë kohë qëkur shëtisnin dorë për dorë profesori e mësuesja që i njëjtte tërë Kaçaniku.

Axhib Tusha ishte i pari djalë në Kaçanik që ecte rrugës së qytezës dorë për dorë me të dashurën e tij mësuese... Dhe, shumëkush ua kishte lakmi, por kishte edhe të atillë që shprehnin zemërim, sepse nuk ishin mësuar me një pamje të tillë...

Dhe, ndarja e tyre ishte e pabesueshme, sepse të gjithë ata që i njihnin mendonin se ishin çifti më i lumtur...

E, pse ndodhi ndarja?

Për hiçgjë! Nga dashuria e madhe e tyre lindi xhelozia dhe e shkatërroi gjithë atë që kishin krijuar bashkë...

Dhe, një ndarje e tillë sot as që do të përmendej, sepse ndodhin ndarjet edhe atëherë kur kanë arsye, por edhe atëherë kur njërit nga çifti i teket të ndahet se kinse boll jetuan bashkë...

Madje, sot disa çifte as që martohen, por bashkëjetojnë. Nuk kanë obligime për njëri-tjetrin, nuk kanë kurorëzim, i kanë dy kuleta dhe nëse ua kënda martohen, e nëse nuk ua kënda ndahen!

Kur i dëgjoj prindërit kah thonë po më bashkëjetojnë çika apo djali me dikë, duket sikur nuk ka asgjë të keqe, jonormale.

Por, kur e analizon se ata bashkëjetojnë, madje edhe lindin fëmijë dhe ndahen pa kurrfarë arsye, kjo nuk tingëllon mirë, nuk tingëllon si diçka normale.

A ËSHTË EDHE TASH SI DIKUR NË KAÇANIK?

Tash rinia shihen rrugëve kudo nëpër Kaçanik, përqafohen në prani të të tjerëve, puthen, dashurohen, por edhe në fshatra, madje. Dhe, askujt një gjë e tillë nuk u bënë përshtypje...

Por, që të ndodhë kështu, është nevojitur të kalojë kohë e gjatë, gjysmë shekulli...

Dhe, kur dashurinë e profesorit me mësuesen që e zëmë në gojë më lart e shikon nga prizmi i së kaluarës, njeriu sikur ka një nostalgji për atë kohë, që nuk kthehet dot... Ngjashëm me odat që s'i kemi më, ashtu siç nuk i kemi në krye të oxhakut as burrat me mustaqe... Por, koha për vajtim nuk është.

Sidoqoftë, ta kujtojmë të kaluarën është mirë, sepse, nëse për hiçgjë më shumë, na përmallon, na e kujton një nostalgji...

Dhe, sa herë që i flas tim bir, Drinit, se dikur ka qenë ndryshe, si rasti i Kaçanikut, habitet dhe nuk mund të besoj në diçka të tillë...

Sokol Murturi

Shyqyr që të paskan vdekur nëna e baba!

Si nënë e vakive që jam, një pasdite, teksa dua ta blej në treg një gjel, e që nuk gjendet asnjë as për ilaç, kthehem për në shtëpi, pra rrugës kah kam ardhur. Por...

Posa dal në rrugën kryesore, një vajzë ngritë dorën që ta marr me veturë. Them me vete: ta ndali, por ishalla nuk është si njëra që e pata marrë para një kohe në veturë...

Posa e ndali veturën, futet brenda në veturën time.

"Si je? A je mirë? Si e ke nënën, babën? Si janë në shtëpi?", më thotë. E shikoj mirë në sy, mos po del e familjes, por më bie në mend se nëna

dhe babai më kanë vdekur që moti.

"Mirë jemi. Nëna e baba më kanë vdekur, kurse të tjerët mirë jemi".

"Po mirë, pra, bash në kohë të duhur paskan vdekur, për besë, sepse koha e tashme nuk duron më pleq. Më mirë që kanë vdekur. Pse të jetojnë më pleqtë?!"

"Më fal, a i ke njohur ti prindërit e mi, a?", ia kthej.

"Jo-jo, nuk i kam njohur, por ma merr mendja se kanë qenë të vjetër".

"E ti, sa vjeçe je?", i them.

"Po, ku pyetet femra për moshë, o burrë?!", shpejt ma pret ajo.

"Mirë e ke, por ti nuk po më dukesh se ke hyrë në rend të femrave, sepse ende qenke e re!"

"A po më dërgon deri në Fushë-Kosovë se e kam një shoqe të bukur atje?", ma ktheu në vend të përgjigjes.

"A po zbret, sepse unë nuk shkoj në Fushë-Kosovë!", i them, teksa e ndali veturën në mes të rrugës.

Dhe, përnjëherë më sillet në mendje se, ndoshta, edhe vajza ime është diku rrugëve, duke i ndalur veturat si kjo...

DIKUR SHKONIM NË POLONI PËR FEMRA, TASH POLAKËT VIJNË NË KOSOVË!

Në çast m'u kujtua Polonia. Koha kur ne shkonim atje, shumica për vajza të reja...

E tash, në Kosovë, vijnë polakët dhe, me siguri, kënaqen me femrat tona, sepse nuk thonë kot se asgjë nuk mbetet për dynjanë tjetër...

Kjo po ndodh edhe me arabët, të cilët dikur në Poloni bënin kërdi me femra të reja, të bukura, duke u hedhur polakeve në trupin e tyre të njomë dollarë amerikanë.

E, së shpejti edhe femrat e tyre do të jenë pre të evropianëve, sigurisht edhe të polakëve.

S.

Ku ndodhen “Varret e dasmorëve” dhe pse janë nën ujë?

Në Orllan të Podujevës, para pak vitesh uji në Liqenin e Batllavës pat rënë dukshëm. Madje, dolën edhe disa varreza që shumë breza njerëzish as që i kishin parë ndonjëherë. E, për to dinin vetëm më të moshuarit...

Në Orllan, më poshtë pishave, te “Plazhi numër 5”, duken gurët e disa varreve. Banorët e këtushëm tregojnë se ato dikur quheshin “Varret e dasmorëve”. Gojëdhënat tregojnë se dikur, në një kohë, ishin takuar dy palë krushq në po të njëjtën rrugë. Sipas adetit, nuk duhej ta lëshonin rrugë. Fillon përleshja ndërmjet tyre dhe shumë sish mbesin të vdekur, e që i varrosin po në të njëjtin vend. Që atëherë vendi njihet me toponimin “Varret e dasmorëve”. Gurët e varreve të dasmorëve, e që edhe i kemi në foto-grafinë tonë, dëshmojnë se të vdekurit i kishte mbuluar uji i liqenit. Se aty ishin varrosur dasmorët e dëshmon edhe Rrahimi, që si fëmijë kishte dëgjuar nga gjyshi i tij, Rama.

Dalja e tyre mbi sipërfaqe, sikur ua kthen kujtesën banorëve të kësaj ane se dikur aty ishin përleshur dasmorët. E, sipas Rrahimit, ku të dijë njeriu se ç’mund të del mbi sipërfaqe po të shterojë edhe më shumë liqeni... Ai dhe bashkëfshatari i tij nuk kanë koment nëse, ndonjëherë, është folur apo bërë diçka për zhvarrimin e eshtrave të dasmorëve nga ai vend me ujë në një vend më të përshtatshëm, pa marrë parasysh se cilës kohë i takonin të vrarët. Në pyetjen se deri tash paskemi pirë ujë të varreve, ai dhe bashkëfshatari i tij nuk flasin se paskëshim pirë ujë të varreve, meqë ndihen keq për këtë gjë. I rrudhin krahët dhe nuk thonë gjë për këtë punë...

S.



DENTFIX
ORDINANCA STOMATOLOGJIKE

As njeriu më i lumtur nuk i ka të gjitha të mirat...

3 këshillat e gjyshes ma shpëtuan martesën

Jam grua e re me moshë. Ka disa vjet që jam martuar dhe deri para një kohe gjërat shkonin mirë me burrë, por kohëve të fundit kanë ndryshuar, sepse, si duket burri po më tradhton.

U solla e pështolla dhe vendosa të këshillohesha me gjyshen se a duhet të ndahem nga burri apo si ta përballoj jetën në këtë gjendje si jam tash... "Gjyshe, unë po heq dorë, thjesht, nuk jam aq e fortë sa për ta përballuar këtë. Gjithçka duket se po shkon keq. Dhe, kur një problem duket se po zgjidhet, paraqiten dhjetëra të tjerë më të rëndë. Të betohem, nuk mund ta përballoj dot më këtë situatë!", i thash.

SI MË BINDI GJYSHJA QË TË MOS E BRAKTISJA BURRIN?

Gjyshja, pasi më dëgjoi me vëmendje, fshihi lotët nga sytë dhe më tha që të kalojmë bashkë në kuzhinë. I mbushi tri enë me ujë dhe i vuri në zjarr.

Kur filluan të vlojnë, në njërën hodhi karotë, në tjetrën vezë dhe në të tretën disa kokrra kafeje.

Pasi vluan një 20 minuta, i largoi përbërësit nga tenxheret dhe i vendosi në enë të veçanta.

"Më thuaj, çfarë po sheh?", më tha gjyshja.

"Karota, vezë dhe kafe", ia ktheva.

"Shijoi karotat, pastaj merre një vezë dhe, në fund, pi një gëlllënkë kafe!", më urdhëroi gjyshja.

"Çfarë përpiqesh t'më thuash me këtë, gjyshe?"

"Shiko, e dashur, secila prej këtyre ushqimeve u përball me të njëjtën sasi të ujit dhe secila ka reaguar në mënyra të ndryshme.

Karota ka përbërje të fortë, megjithatë, kur ajo zihet në ujë të nxehtë, zbutet.

Veza është e brishtë, vetëm lëvözha e

hollë e mbron atë, mirëpo pas vlimit ajo forcohet.

Kafeja është e ndryshme në krahasim me dy përbërësit e mëparshëm. Në vend që uji ta ndryshojë atë, kafeja e ndryshon ujin!

Pra, cila prej këtyre je ti:

A je si karota, e cila nga pamja e jashtme duket e fortë, por kur zihet bëhet e butë?

A, ndoshta, je si veza, e cila i përshtatet ndryshimeve të nxehtësisë?

Apo, ndoshta, je si kokrra e kafesë, e cila e ndryshon ujin?

E, nëse je si kafeja, e cila kur të zihet lëshon një aromë të këndshme, atëherë kur gjërat të duken shumë keq, në vend që të heqësh dorë, bëhu më e mirë dhe më e fortë – ndrysho situatën dhe rrethanat rreth teje dhe mos lejo që rrethanat të të ndryshojnë ty!"

Dhe, nga këshilla e saj mësova aq shumë sa erdha në përfundim se as njerëzit më të lumtur nuk i kanë të gjitha të mirat, as nuk e kanë çdo ditë fushë me lule...

Pra, sekreti i njerëzve të lumtur është që ata të nxjerrin më të mirën nga çdo situatë që u vjen në jetë...

R. Zh.

Jetoj me burrë në shok-dhomë!

Mungesa e seksit në martesë duket se është një episod që përjetohet më keq nga gratë sesa nga burrat, sidomos kur ata që e refuzojnë raportin intim janë këta të fundit.

MENDOJNË SE KAM MARTESË TË MIRË, POR JO!

"Jam qe dhjetë vjet në martesë dhe, marrë në përgjithësi, të gjithë që më njohin mendojnë se kam martesë të mirë. Mirëpo, nuk është bash kështu", shprehet Nora, nga Fushë-Kosova, në pyetjen që ia bëmë se si i shkon jeta në martesë.

Nora, 32-vjeçe, pohon se kur ajo dhe burri i saj u takuan 15 vjet më parë, ata bënë seks në çdo kohë që mundnin. Por, pas pesë vjetësh martesë, jeta e tyre seksuale filloi të tkurrej, nga shumë herë në javë, në një herë muaj! Ajo nuk është e lumtur me këtë gjë, por burri i saj nuk është i interesuar për seks dhe nuk dëshiron të flasë sesi mund ta përmirësojnë këtë gjë që ajo e sheh si një problem të madh.

"Kam marrë një mori ankesash nga ai. Ai nuk është i disponuar, sepse puna në lokalit e tij tregtar nuk po i shkon si duhet, se gjithmonë vjen në shtëpi i lodhur, se ka dhembje lukthi a gjetiu...", thotë ajo, e zhgënjyer me jetën e saj seksuale.

SI I HUMBI BURRIT DËSHIRA PËR SEKS?

Ajo dyshon se burri i saj, nëse nuk ka femër tjetër, ka humbur dëshirën për seks, por ai ka refuzuar të vizitohet me mjeku, me qëllim të tejkalimit të këtij

problemi bashkëshortor.

Kur ajo flet për mungesën e seksit në raportin e tyre, burri i saj ose mbyllet ose merr pozicion mbrojtës. Ajo i qahet atij se kështu ajo ndihet e shëmtuar dhe se ata janë kthyer në shok-dhomë.

Gratë, ndoshta, nuk mund të varen nga burrat për të qenë nxitëset seksuale në marrëdhënie, por kjo nuk do të thotë se ato janë imune në refuzimin e seksit, sidomos me normat tona tradicionale gjinore ende me ndikim. Burrat ndjehen të poshtëruar kur ata nuk mund të kryejnë seks, edhe nëse kjo është një pengesë psikologjike apo çështje fiziologjike.

Shkaqet e zakonshme fiziologjike që çojnë në rënien e dëshirës seksuale të burrave përfshijnë mosfunksionim të ereksionit, si përdorimi i medikamenteve (ilaçet kundër depresionit) dhe testosteroni i ulët ose problemet e marrëdhënieve në çift, thonë psikologët.

Diturie Haxhaj

*Çdo të premtë
pasdite, katër vjet
rresht, udhëtoja
nga Prishtina për
në Pejë, e kthehe-
sha të dielën në
mbrëmje, meqë të
hënën në mëngjes
më prisnin ligjëra-
tat në Fakultetin e
Shkencave Naty-
rore, në Degën e
Kimisë.*

Në fund të viteve 90, gjatë udhëtimit me tren nga Fushë-Kosova për në Pejë dhe anasjelltas për katër vjet rresh, kam përjetuar ndodhi e ndodhi, meqë edhe policia serbe shpesh na i kërkonte letërnjoftimet dhe arsyen pse udhëtonim...

Por, këtë herë nuk do të merrem me policinë serbe, e cila herë-herë dinte edhe të na jepte ndonjë shufër gome në shpinë.

Këtë herë po e qes në letër një kujtim të mirë, e që, edhe pse kanë kaluar vite e vite, nuk më hiqet dot nga mendja.

Një femër engjëlllore, rreth të njëzetave, në korridorin e gjatë të vagonit vinte drejt meje. Në korridor kishte shumë udhëtarë, andaj edhe nuk kishte vende të lira për ulje. Kur u afrua afër meje, jam i vetëdi-jshëm se pa kurrfarë qëllimi, u kthye në krah për të kaluar afër meje. Por, floku i saj i dendur e i gjatë ma dha fytyrës "një shuplakë".

"Më fal, të lutem!", ma ktheu ajo.

"Po, të falë me një kush: Përsërite edhe një herë!", më dolën fjalët sikur i kisha në maje të gjuhës.

Ajo qeshi dhe vazhdoi ecjen, në kërkim të ndonjë vendi për ulje.

Por, që nga ajo ditë, në mua mbeti një brengë - pse nuk iu vardisa, që të njihesha me të...

E. Zekaj, Pejë



***Era e flokut të saj
ma ngulfati frymën!***



PARA

PAS



20 SEANCA

-13 KG

Qendrat e dobësimi 'Shkenda Dubova' janë ndër bizneset më të suksesshme të vitit. Duke filluar me një degë të vetme në Prishtinë, biznesi i Shkendës sharmante, ka kaluar kufijtë kosovar. Tani, qendrat e dobësimi gjenden edhe në Shqipëri, Gjermani dhe Zvicër, e njëkohësisht pritet që të hapen edhe nëpër vende të tjera të botës.

Gjithsesi, suksesi i tillë vjen si rezultat i punës së palodhshme të Shkendës dhe stafit të saj, mirëpo edhe i shumë storjeve të suksessit, të qindra klientëve të kënaqur.

Kush thotë që një femër nuk është e denjë për biznes?

Shkenda Dubova e dëshmon të kundërtën, duke qenë shembulli më i mirë i femrës kosovare të suksesshme.

Shumë mund të pyesin se si ndodhë i gjithë procesi i dobësimi tek këto qendra, me rezultate kaq

të dukshme tek klientët? Çdo klient fillon me seancat e shkrirjes së dhjamit, përmes aparaturave më moderne, që janë në përputhje edhe me standardet evropiane të teknologjisë së dobësimi.

Kështu, klienti së pari i nënshtrohet një analize trupore, ku përcaktohen: masa dhjamore, masa hidrike, masa muskulore dhe skeletore, si dhe metabolizmi. Si rezultat i kësaj terapie, klienti humbet 5-8 kg në 10 seanca të plota dobësimi, me një reduktim të perimetrit deri në 10 cm, për vetëm 10 seanca.

I gjithë ky proces ndodhë falë këtyre aparaturave, karakteristikat e të cilave do t'i shohim në vijim:

- Perfect Body-Tunnel Sauna - Është një aparaturë e teknologjisë së fundit, dhe rezultat i një projekti të gjatë kërkimor, efikasiteti i së cilës është verifikuar shkencërisht në të gjitha aspektet mjekësore e teknike, pa efekte anësore, e po ashtu, edhe kuruese për shumë sëmundje. Kjo aparaturë funksionon duke aktivizuar molekulat e ujit, që përmirësojnë thithjen e oksigjenit, qarkullimin e gjakut dhe nxisin metabolizmin. Rrezet infra të kuqe të afërta dhe të largëta, kombinohen për të depërtuar në indet e lëkurës deri në 30% (6 mm nën epidermë), duke shpërbërë grumbullimin e yndyrës të lokalizuar në bark, vithe dhe kofshe. Në mjekësi, IR përdoren për shërimin e shumë sëmundjeve si: sëmundjet reumatike, sëmundjet degenerative të nyjeve, gjendjet postraumatike (kryesisht sportistët), inflamacionet e hapësirave paranazale etj.
- Body Shape-Kabina e Shtrirë - Një tjetër pajisje që sjellë benefite të jashtëzakonshme për shëndetin, e në veçanti në humbje të peshës. Kjo aparaturë realizon një funksion të rëndësishëm në relaksim dhe detoksifikimin e tyre, duke larguar toksinat dhe acidin laktik. Benefitet kryesore të kësaj aparature janë:

- Riaktivizon metabolizmin dhe ndihmon në eliminimin e shtresave të tepërta dhjamore, duke eliminuar kilogramët, dhe duke ofruar rimodelimin e formës trupore;
- Lehtëson dhimbjet nga patologji të ndryshme, si dhembjen e kurrizit, nervit ishiatik, artritin, reumatizmin;
- Rritë qarkullimin e gjakut duke furnizuar kështu indet dhe çdo pjesë të trupit, me elemente ushqyese;
- Tonifikim i thellë;
- Përmirëson shëndetin e zemrës dhe ulë stresin;
- Përmirëson sistemin nervor;
- Zhdukë në mënyrë të ndjeshme celulitin duke eliminuar shtresat dhjamore;
- Ngadalëson efektin e plakjes, duke përmirësuar dukshëm elasticitetin dhe butësinë e lëkurës;
- Përmirësim i dukshëm i drenimit të toksinave dhe i lëngjeve;
- Detoksifikim i organizmit, rritje e forcës dhe fleksibilitetit;
- Lehtëson gjendjen e depresionit;
- Efekt analgjik;
- Lehtëson dhimbjen dhe përmirëson lëvizjet te personat që kanë sëmundje reumatike, etj.

• Sauna Tradicionale nga Druri i Pishës - Është aparaturë ku përmes efektit termik të nxehtësisë, ndihmon në eliminim e shtresave dhjamore dhe humbjen e peshës. Disa nga benefitet e saunës me nxehtësi janë:

- Detoksifikim;
- Përmirëson qarkullimin e gjakut dhe ulë tensionin arterial;
- Humbje të peshës;
- Eliminon celulitin edhe nga zonat më delikate;
- Relaksim muskolor, etj.

• Pajisja e Dobësimi Intensiv (Ultra Sonik) - Kjo pajisje funksionon përmes valëve sonike të frekuencës 40000Hz, të gjeneruar nga sonda. Pasi valët hyjnë në trupin e njeriut, gjenerohet efekt intensiv goditës në qelizat dhjamore, si dhe lëvizje ndërmjet qelizave dhjamore, të cilat në mënyrë efektive djegin energji, dhe kështu ndodhë tkurja e qelizave dhjamore. Ndërkohë, vibrimi i valëve sonike, shkakton ndikim intensiv midis qelizave, të cilat shpërthejnë menjëherë, duke zvogëluar numrin e qelizave yndyrore dhe arrijnë efektin e heqjes së dhjamit.

• Elektrostimulorët Muscular - Ky është procesi i fundit që bëhet gjatë një seance. Është një proces shumë i rëndësishëm, përderisa jeni duke shkrirë dhjamin, përmes elektrostimulimit, tonifikohet trupi, nuk e lë të varet dhe të qullët trupi, si dhe stimulohen muskujt dhe ngushtohet perimetri.



Mu kanë lye femrat dhe s'po di ç'të bëj me to!

Të dielën e parë të prillit, teksa po shkoja në drejtim të Shkupit, ishte ditë e ngrohtë pranverore. Një femër ma bën me dorë në formë “stop” në rrugë, në përfundim të rrugës autostradë, te QMI-a, te ndarja e rrugës për Shkup e Prizren. E ndala veturën, me qëllim që ta pyesja se ku shkonte. Por, ajo pa një e pa dy hyri në veturën time...

Dhe, për të parën herë më ndodhi diçka e tillë në jetë, sidomos me një vajzë të re si ajo.

“Si je, o burrë? A je mirë? Si i ke në shtëpi? Si janë të gjithë? A po lodhesh? Çka po bën dhe nga po shkon?”, m'i tha të gjitha, pa pritur përgjigje...

“Jam duke shkuar në Ferizaj”, i them unë. “Të mora sepse po shkoj në drejtimin kah po shkon edhe ti, si duket...”

“Në rregull, por unë tashmë jam e rritur dhe futem në cilën veturë dua!”, ma ktheu ajo.

“Aha, më vjen mirë, mos ma zë për të madhe se kam qëlluar paksa naiv e nuk i marr vesh këto sende shumë. Po, sa vjeçe je, moj çikë?”, ia kthej unë.

“Jam 24, e rritur”, më thotë ajo.

“Ku shkon, ku e ke stacionin e fundit?”

“Stacionin e kam deri ku shkon edhe ti!”

“Nuk po të kuptoj, më fal, ma sqaro më mirë këtë punë!”

“Shkoj ta pres një njeri”.

“Ti të presësh njeri, këmbë, a?!”.

“Po, me “Reno 2”, do e pres e ai do vijë!”.

“Ku do të zbresësh, pra?”.

“Zbres në Prelez, te bagremët”.

“Mirë shumë”, i them unë, teksa ajo i përgjigjej një personi në telefon, duke i bërë titur pse po e shqetësonte gjatë tërë ditës.

“Mos më thirr ma në telefon se ta luaj nënën! Harroje këtë numër!”, i thotë, duke e sharë dhe bërë horë.

ANI, DJALI I MIRË, A JE I MARTUAR?

“O djalë i mirë, çka ka të re kah ti?!”, më pyet si me ironi.

“Mirë është çdo gjë, por të reja nuk ka,

krejt plaka!”, i them unë.

“Ani, a do të reja, pra?! A je i martuar?”.

“Jo, faleminderit shumë, i kam bërë do vjet dhe i kam lënë këto punë, sepse duhet të ketë njeriu një stacion ku ndalet. Duhet ta ketë një Prelez, si ti...”.

“Ha-ha-ha, ti plak, a?!”.

“Po, për besë, shkoi jeta, oj çupë, tash duhet të jetohej me fytyrë, e jo duke e humbur fytyrën!”, i them me krenari.

Dhe, ajo, pa një e pa dy, ma kthen:

“A po ma ndal këtu veturën, pra?”.

“Po, si jo. Dhe, falë Zotit që po zbret!”, i them unë.

E ndali veturën dhe ajo pa më përshëndetur del nga vetura. Lirohem prej saj dhe marr frymë lirshëm. Lirohem nga një barrë që nuk më kishte ndodhur kurrë më parë, edhe pse kam udhëtuar shumë...

S.

Ka dy vjet që punojmë bashkë, në të njëjtën shkollë. Filimisht më tërhiqte si arsimtare, por asgjë më shumë se aq. Me kalimin e kohës nisa ta njihja edhe më mirë, sepse e kalonim një pjesë të mirë të ditës bashkë. Por, nuk shkoj gjithçka si miq. Raporti ynë u avansua në dashuri...

Një ditë, pas mësimi, e ftova për kafe. Ajo më tregoi se ishte grua e martuar, e që unë deri atë ditë nuk e kam ditur. Dhe, u ndjeva keq e ftova në kafe, se ndoshta mund të kishte probleme me burrë, pastaj... Por, edhe ditëve të tjera vazhdoja të kaloja një pjesë të madhe të kohës me të. E pyesja vazhdimisht se si i kishte punët me burrë dhe më thoshte se nuk kishte ndjenja për të dhe se tashmë i kishin humbur shpresat se mund të vazhdonte me të, edhe

Arsimtarja më futi si dreqin në gastare!

pse ai ishte shumë i sjellshëm, i mirë. I thashë që të ishte e sigurtë me burrë dhe t'ia thoshte të vërtetën... Sidoqoftë, shoqëria jonë vazhdonte dhe ndjenjat për të më forcoheshin gjithmonë e më shumë. Kisha vënë re se as ajo nuk ishte indiferente ndaj vëmendjes sime. Një pasdite dolëm nga shkolla bashkë dhe pasi pimë kafe në një qosh ku të tjerët nuk na shihnin u puthëm.

MË THA SE ËSHTË NDARË NGA BURRI, E FLINTE ME TË!

Kaluan tre muaj nga ajo ditë dhe lidhja jonë dukej se shkonte mirë. Unë, të them të drejtën, isha marrëzisht i dashuruar në të, por nuk do ta kisha menduar kurrë se do t'më zhgënjente dhe do të lëndohe-sha aq shumë prej saj.

Pas ndarjes me burrë ajo kishte vazhduar t'i ruante kontaktet me të dhe ishin takuar disa herë, por pa dijeninë time. Në një nga këto raste ajo kishte shkuar në shtrat me të.

Si e zbulova?

Një ditë pas mësimi u ndala në shkollë, se më duhej të punoja në ditar. Gjatë asaj kohe më telefonoi dhe kërkoi t'ia fikja kompjuterin e saj, sepse

e kishte harruar e-mailin e hapur. Kur shkova ta mbyll, vura re se në listën e e-maileve ishte edhe emri i ish-burrit të saj. Nuk më la kureshtja dhe e hapa. Ai i kishte thënë se vazhdonte t'i kishte të njëjtat ndjenja për të dhe se i vinte mirë se edhe ajo i kishte treguar natën që kaloi se vazhdonte të ndjente diçka. I kishte thënë se kishte dëshirë që net të tilla si e një nate më parë të përsëriteshin më shpesh. U trondita, nuk arrija të besoja në një gjë të tillë. Nuk i thashë asgjë dhe bëra sikur nuk e kisha lexuar atë e-mail.

SI ERDHI FUNDI?

Të nesërmen i thashë se e kisha lexuar e-mailin e saj dhe se ndërmjet nesh çdo gjë kishte përfunduar. I dolën lotët dhe më lutej ta falja, sepse gjithçka kishte ndodhur në një moment dobësie dhe se nuk ishte e qartë me veten për ndjenjat që kishte për mua dhe për ato që ndjente për ish-burrin. Më kërkoi falje dhe m'u lut që ndarja jonë të mos ishte përfundimtare dhe t'i jepja pak kohë që ta sqaronte me veten se çfarë po ndodhte.

Nuk iu përgjigja dhe, në fakt, nuk kam një përgjigje për këtë. Nuk e di nëse do mund ta fal dhe të harroj gjithçka...

Th. Misini

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depressive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

Magjitet e Shëngjergjit a ekzistojnë dhe sa janë të fuqishme?

Përshëndetje, u shkruaj nga Gjilani, jam 64-vjeçar. Kam punuar disa vjet profesoreshë. Meqë jemi afër muajit maj, pyetja ime është:

A ekzistojnë magjitet e Shëngjergjit, meqë jemi rritur me frikë e me shumë rituale që i përkasin pesë ditëve të Shëngjergjit?

Dhe, pse janë të fuqishme ato magji dhe si ndodhin?

"Gavrani 2"

Përgjigje:

Shëngjergji është festuar nga shumica absolute e popujve të botës, që jetojnë me kalendarin tonë stinor. Dhe, ky festim, kishte të bënte me shumë aspekte të mbijetesës dhe të dominimit ekonomik dhe personal. Shëngjergji festohet ende, posaçërisht në Ballkan, sado që diku-diku ceremonitë e kësaj kremteje janë zbehur.

Jo shumë moti, Shëngjergji është përshkuar me grumbullimin e vajzave, të cilat kanë shëtitur gjatë pesë ditëve të Shëngjergjit në vendet ku kanë

jetuar. Vajzat janë njohur ndërmjet veti, por edhe fshati, falë të kremtes së Shëngjergjit, i ka njohur vajzat e tyre, duke shkuar te njëra-tjetra. Dhe, gjatë këtyre njohjeve kanë përfituar edhe meshkujt, sepse edhe ata janë njohur me to. Sidoqoftë, Shëngjergji festohet për disa arsye: Arsyeja e parë është siguria ekzistenciale e familjeve. Hapja e punëve të fushës dhe përmirësimi i motit nga të ftohtit në të nxehtë dhe nga harxhimet e mëdha gjatë dimrit në harxhimet më të vogla gjatë verës.

Por, Shëngjergji i ka pasur edhe anët e veta negative: magjitet dhe gjërat mitike të keqbërjes, ku magjistarët kanë punuar me fuqitë e veta për t'i mposhtur rivalët dhe kundërshtarët. Përmes mënyrave të shumta të magjive, ata e kanë përçarur përmes frymës së keqe magjinë në një familje, apo te një individ dhe i njëjti, pastaj, ka pësuar. Magjitet janë bërë edhe nën llupën e inateve dhe xhelozive, kur një femër ka qenë më e bukura dhe në atë mënyrë, përmes magjive, kanë punuar që asaj t'i

dëmtohet bukuria.

Magjitet janë bërë edhe për të bërë dëme në ekonominë familjare dhe për të sjellë grindje në shtëpi, përmes disa gjërave që i njej mistika dhe që janë mjete të duhura për me pasur sukses një magji.

Kështu, femrat dikur janë kujdesur që flokun të mos e lënë në krehër, por edhe thonjtë e prerë t'i hedhin, sepse me ta do bënë magji...

Fuqia e magjive të Shëngjergjit lind me ngrohjen e tokës.

Dielli nxehtë tokën dhe e futë energjinë e lartë pozitive dhe negative. Dhe, nga ajo energji, ringjallet gjelbërimi dhe natyra, në përgjithësi.

Një magjistar mund të ketë më shumë fuqi për ta quar në vend një mesazh të keq gjatë Shëngjergjit.

Ndryshe, në kohën e Shëngjergjit tokës i kthehet shpirti, për çka del gjelbërimi, e që ndritë syrin dhe ndjenjën për nostalgji dhe reflektim ndaj dukurive të caktuara dhe aty lindi magjia, e që sot përdoret në tërë botën.

Pra, ekzistojnë magjitet dhe njëri ndër ta, që bënte magji, ishte edhe Hazreti Musai, si i dashuri i Zotit, që ai i dha fuqi për ta shpëtuar popullin.

Si e gjykon ligji gjakun e falur?

Jam një burrë nga Maqedonia, 78-vjeçar, jetoj në rrethin e Shkupit.

Më intereson të di një gjë nga gjykimi i Kanunit të Lekë Dukagjinit: Nëse dorasi që

ka bërë vrasje pajtohet me familjen e dëmtuar, akoma pa iu shqiptuar dënimi me burg për vrasësin, a duhet ta falë gjyqi institucional?

“Kanuni”

Përgjigje:

Kur bëhet një vrasje, do të thotë bëhet një krim: i merret jeta një njeriu, privohet një njeri nga jeta. Dhe, pas vrasjes mbetën shumë pasoja. Njeriu që nuk është më në jetë, mund të ketë lënë fëmijë dhe grua. Dhe, përveç anës traumatike, krijon edhe pasoja sociale. Ligji sanksionon vrasësin, pa marrë parasysh a janë pajtuar familjet a jo.

Konkretisht, ligji ekzekuton dënimin apo dënon vrasësin dhe ndihmësit e tij apo shtytësit e vrasjes.

Krejt çka mund të ndodhë për mirë është se mund të ketë lehtësim dënimi, qoftë me burg më të lehtë apo me kohëzgjatje më të shkurtër.

Por, dënimi bazik është sanksion ligjor.

Pajtimi ndërfamiljar, që mund të ndodhë rrallëherë para se të jepet verdikti gjyqësor, mund të jetë lehtësim për vrasësin, meqë shteti mund ta merr në konsideratë ndërprerjen e hakmarrjes, pasojën zinxhirore të hakmarrjes, e të tjera akte që janë të karakterit moral dhe paragjykses, e që bëjnë pjesë në kodin e traditës.

A do të heqë dorë burri prej meje?

Jam 34-vjeçare, jetoj jashtë Kosovës. E kam një fëmijë. Burri nuk jeton me mua, por

në Kosovë. Ka kohë që ai më paralajmëron për ndarjen tonë.

A do të ndahemi?

“BL”

Përgjigje:

Bashkëshortësia ka kuptim kur çifti jeton bashkë dhe i ndanë problemet e përditshme së bashku.

Ju keni fëmijë, por ai nuk jeton me babanë e vet, ashtu qysh nuk jeton as ti me personin që e ke burrë.

Fakti se ai paralajmëron ndarje, do të thotë se ju i mungoni njëri-tjetrit dhe se nuk jetoni si burrë e grua. Këtu mungon interesimi juaj për të jetuar bashkë: Ose ti nuk e merr atje ku je ose ai nuk do të jetojë me ty atje.

E, kështu qysh jeni aktualisht, nuk u shoh bashkë.

Jetoj me të, por nuk e dua!

Jam 51-vjeçare, e di se jeta ime ka marr formën e vet që nuk duhej ta kishte...

Jam martuar qe 27 vjet, por e kam dashur dikë tjetër dhe ende e dua, edhe pse lidhja jonë ishte ndërprerë qysh kur më fejuan me njeriun me të cilin jetoj tash.

Kurrë nuk kam qenë e lumtur...

Tash fëmijët janë rritur: dy janë martuar, por jeta ime vazhdon me vështirësitë e veta, shkaku se jam shumë e palumtur me të gjitha.

E di se më nuk ka shpresa për asnjë ndryshim, se kam ëndërruar që do më lëshoj burri dhe, të paktën, do të

PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: “Kosovarja”, fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

isha e lirë prej tij. Por, kjo nuk ndodhi kurrë.

Dua të di se a do t’më përmirësohet shëndeti, sepse kam shumë probleme dhe, pikërisht, kur e lut Zotin për vdekje, ajo nuk vjen?

“Pa lumturi”

Përgjigje:

Lumturia është vetëm një nocion, të cilin e përdorin rinia kur janë në kulmin e dashurisë rinore. Nuk ekziston lumturia si realitet, por pjesërisht ka shtrirje te njeriu.

Megjithatë, kanë kaluar 27 vjet prej kur ti ke krijuar një jetë të re me njeriun me të cilin i ke lindur tre fëmijë.

A ka dikush që mund ta bëjë njeriun më të lumtur sesa fëmija? Me siguri, s’ka.

Duhet ta ktheni shikimin te familja, te fëmija dhe të kuptoni se lumturinë që e keni ëndërruar nuk do ta gjenit as te ai që ende e doni...

Ke bërë jetë duke fantazuar. Ke jetuar me iluzione...

Dëshiroj që këto që po t’i them të të shërbejnë si fakte që t’i kujtosh shpesh dhe ta shërosh shpirtin. Prandaj, mos krijo probleme për diçka që nuk i ke realizuar. Sepse, ka qenë vendim i Zotit të madhërishëm që të ndodhin gjërat në këtë mënyrë dhe duhet të pajtohesh me to.



Mistikë dhe realitet

Në cilët njerëz rri dreqi?

“Nata është e pabesë”, thotë një fjalë e urtë popullore. E, pse është e pabesë? Sepse, nuk shihet gjithçka...

Në praktikën e punës sime kam marrë mesazhe të shumta dhe mund të them që me të zgjuar në mëngjes, zonja e shtëpisë ka gjetur në oborr, në ballkon, gjurmë gjaku, për të cilin nuk ka shpjegim se nga ka ardhur dhe kush e ka shkaktuar.

Kur jemi te gjaku, ka raste të shumta dhe të panumërta, kur edhe muri i shtëpisë është gjetur i lyer me gjak! Nëse i referohemi përvojës, qindra mesazhe që kam marrë kanë paraqitur frikën tmerruese se zonja e shtëpisë, apo nusja ka gjetur vezë në ormanin e rrobave të veta.

“Nga erdhën vezët?”, është pikëpyetje për shumë njerëz, që besojnë apo nuk besojnë në magji e në gjëra që quhen mistikë, por që, de fakto, kanë ndodhur dhe ndodhin akoma.

Në tavanet e shtëpive, gjithashtu, ka shumë njerëz që gjejnë vezë dhe të njëjta i gjejnë në oborre të shtëpive edhe kur jetojnë në qytet.

Për më keq, edhe sot, si në të kaluarën, njerëzve u ndodhë shumëçka. Çdo njeri e ka një përvojë të hidhur me diçka që jeton i tmerruar dhe i impresionuar, sikur ne që shohim UFO, apo që jetojmë me enigmën a na vizitojnë alienët, jashtëtokësorët apo jo...

Nga përvoja do ndajë disa storje nga jeta, të cilat u kanë ndodhur njerëzve apo u ndodhin edhe sot...

A EKZISTONTE BOLLA QË E SHTRËNGONTE DJALOSHIN DERISA FLINTE?

Një djalë nga fshati Remink i Anamoravës, ankohej se me vite e shtrëngonte natën një gjarpër në gjoks derisa flinte. Shtëpia e tij ishte e vjetër. Themelet i kishte me gurë, kurse muret me qerpiçë, por e lyer mirë. Tavani i shtëpisë ishte me dërrasa të trasha dhe në mesin e tavanit ndodhej

trari i madh, mbi të cilin binte pesha e dërrasave.

Djaloshi që ankohej thoshte se çdo natë, derisa flinte, një gjarpër i zi zbriste nga tavani dhe e lidhte, duke e shtrënguar në gjoks.

E, a kishte gjarpër në shtëpi, e që jetonte në tavan ndërmjet dërrasave, askush nuk mund të garantojë, por aty ishte një problem. E, në tavanin e shtëpisë nuk kishte gjarpër. Nuk kishte as vrimë nga do të dilte gjarpri për ta shtrënguar...

Po në atë shtëpi, në të kaluarën, kishin ndodhur edhe shumë gjëra të pabesueshme. Në ahurin e bagëtisë diçka e padukshme i trazonte lopët!

Madje, edhe kur kujdestaronin familjarët, ndodhte që qenia e padukshme i trazonte kafshët! Nuk shihej asgjë, por bagëtia nuk zinte vend askund dhe desh e thyenin derën për të ikur jashtë!

Rekomandimi ishte që të braktisej shtëpia dhe ashtu ndodhi. 100 metra më larg u ndërtua shtëpia e re dhe më nuk ndodhi kurrë të shtrëngohej djali nga gjarpri.

Magjistarja e “Kosovares”



SHERWOOD

Resorts and Hotels

Feel the Legend

**SHERWOOD
EXCLUSIVE KEMER**
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD
EXCLUSIVE LARA**
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD
DREAMS RESORT**
BELEK / ANTALYA

**TUI BLUE
BELEK**
BELEK / ANTALYA

**SHERWOOD
SUITES RESORT**
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD
GREENWOOD RESORT**
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD
PRIZE HOTEL**
LARA / ANTALYA

+90 242 444 88 07
www.sherwoodhotels.com.tr

